



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

T R A N S K R I P T

I MBLEDHJES PLENARE TË KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS, TË
MBAJTUR MË 11 NËNTOR 2011

SA PLENARNE SEDNICE SKUPŠTINE REPUBLIKE KOSOVA, ODRŽANE
11. NOVEMBRA 2011. GODINE

NËNTOR – NOVEMBAR
2011

E premte, 11.11. 2011, ora 10:00

Drejton seancën: Kryetari i Kuvendit të Kosovës, zoti Jakup Krasniqi

KRYETARI: Të nderuar deputetë,
I nderuar kryeministër,
Zëvendëskryeministër,
Ministra të Kabinetit qeveritar,
I hap punimet e mbledhjes plenare të Kuvendit të Republikës së Kosovës.
Në mbledhje janë të pranishëm 63 deputetë, që do të thotë mund të fillojmë me rendin e ditës.

Pika e parë e rendit të ditës është:

1. Koha për deklarime jashtë rendit të ditës

Koha për diskutime jashtë rendit të ditës është e kufizuar deri në 30 minuta. Diskutimi në emër të grupit parlamentar është 5 minuta, ndërsa në emër të deputetit 3 minuta.

Deputetët e paraqitur për diskutim duhet të deklarohen se në çfarë cilësie e kërkojnë fjalën?

Ne kemi këtu një renditje të deputetëve, por do të ishte mirë ta dinim se a ka të paraqitur në emër të grupeve parlamentare?
Faleminderit!

Në emër të Grupit Parlamentar të Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës,
deputeti Ahmet Isufi e ka fjalën.

AHMET ISUFI: I nderuar kryetar,
Kabinet qeveritar,
Të nderuar kolegë deputetë,

Janë bërë më shumë se 3 muaj nga plani i Qeverisë për të zbatuar rendin dhe ligjin në veriun e Kosovës dhe konsiderojmë se krahas asaj që është thënë se do të jetë veprim konstant i Qeverisë në ndryshimin e gjendjes në veriun e Kosovës, zbatimin e rendit dhe të ligjit dhe rendit kushtetues, në bashkëpunim me mekanizmat ndërkombëtarë, KFOR-in, EULEX-in dhe tjerë prezentë në Kosovë, nuk i kemi rezultatet të cilat janë shpallur nga Qeveria e Republikës së Kosovës.

Këtë e them për arsye se edhe në Raportin e Progresit, kërkohet që ligji, rendi të jenë abc-ja e funksionimit të shtetit të Kosovës dhe po ashtu të ketë angazhime konkrete me plane praktike, të cilat e bëjnë jetën funksionale në veriun e Kosovës dhe e bëjnë Kosovën tërësi territoriale, funksionale.

Kur kemi kërkuar që të ndodhë kjo edhe si përfaqësues politikë edhe si përfaqësues të qytetarëve të Kosovës, të zgjedhur në Kuvendin e Kosovës, shpeshherë është thënë se nuk po jepen ide, nuk po ofrohen plane, nuk po ofrohet bashkëpunim, ndërsa ne këtu kemi ofruar ide,

në këtë Parlament, që të ndryshohet gjendja atje duke konsideruar, se një pjesë e popullatës shqiptare atje është e rrezikuar dhe ka nevojë për mbrojtje institucionale, ka nevojë për nënstacione të policisë, të cilat do të kishin garantuar jetën e sigurt të qytetarëve atje, pa dallim etnie. Kjo nuk ka ndodhur edhe më tutje.

Po ashtu kemi kërkuar që të ketë një plan gjithëpërfshirës të Qeverisë së Republikës së Kosovës, të gjitha institucioneve, të gjitha agjencive, me projekte konkrete investuese, sepse çështja e veriut të Kosovës nuk është vetëm çështje e sigurisë, nuk është vetëm çështje e zbatimit të ligjit, por është çështje funksionale e shtetit të Republikës së Kosovës dhe kjo nuk është marrë edhe më tutje parasysh. Prandaj, e kemi gjendjen si e kemi dhe në vend se instrumentet institucional të Kosovës të veprojnë drejtpërdrejt atje, kemi rrezikim të jetës së qytetarëve kur ligjin atje e marrin qytetarët e pambrojtur, sepse ata duhet të mbrohen nga hajnitë, nga bandat, nga krimi i organizuar që është i instrumentalizuar drejtpërdrejt prej shtetit serb.

Edhe më tutje kërkojmë që edhe si opozitë kur është në pyetje një pjesë e territorit të Kosovës, të jemi të involvuar në mënyrë që të mund territorin e Kosovës ta bëjmë të tërë dhe funksional, prandaj, merrni këto ide parasysh, Qeveri e nderuar dhe mos e neglizhoni këtë çështje.

Dhe, po ashtu nuk kemi nevojë për falënderime, për diskutime, për ato që nganjëherë bëhen edhe cinike, në mënyrë që të devalvohet edhe ajo që është qëllim i mirë për t'u realizuar e drejta kushtetuese në Republikën e Kosovës, për të pasur lëvizje të lirë, për të pasur rend dhe ligj.

Prandaj, kërkojmë që Qeveria, me program konkret t'i qaset veriut të Kosovës, në bashkëpunim me të gjithë mekanizmat ndërkombëtarë që janë në Kosovë dhe në bashkëpunim me partitë politike, me të gjitha institucionet të cilat mund të ndihmojnë në këtë drejtim.

Përndryshe, ne do të kemi në vazhdimësi incidente, do të kemi në vazhdimësi barrikada, do të kemi në vazhdimësi shkelje të rendit dhe të ligjit në Kosovë.

Për të mos e lënë këtë, nuk duhet më të jepen deklarata dhe sa më pak, madje njerëzit e thirrur që të veprojnë, të japin deklarata...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARI: Faleminderit!

Në emër të Grupit parlamentar të Partisë Demokratike, deputeti Ramiz Lladrovci e ka fjalën.

RAMIZ LLADROVCI: Faleminderit, kryetar!

I nderuar kryeministër,

Zëvendëskryeministër, ministra,

Të nderuar kolegë deputetë,

Dua të ndaj sot me ju një shqetësim që besoj duhet të jetë preokupim i të gjithë neve së bashku, sjellja dhe përgjegjësia e pjesëtarëve të caktuar të Policisë së Kosovës.

Ditë më parë, konkretisht më 2 nëntor, derisa i shoqëruar nga kolegu ynë, deputet Fadil Demaku, po e ndiqnin një ndeshje futboll midis klubit futbollistik Hajvalija dhe atij Ferronikeli, në stadiumin e Kishnicës, në afërsi të komunës së re të Graçanicës, ndodhi një incident i pahijshëm, i iniciuar çuditërisht nga një udhëheqës lokal i Policisë së Kosovës.

Zëvendëskomandanti i Stacionit Policor të Graçanicës, rreshteri Ramë Kryeziu, i shoqëruar nga policë edhe të nacionalitetit serb, ka provokuar personalisht një incident të rëndë në tifozët. Ai fillimisht i ka kërcënuar tifozët mysafirë, ata të Ferronikelit, por pasi që ata nuk ranë në provokimet e tij, ai provokoi, pas përfundimit të ndeshjes, tifozët vendas, ata të Hajvalisë.

Sipas krejt situatës, rreshteri Kryeziu insistoi qëllimisht në incident, duke iu vërsulur pa të drejtë dhe pa kurrfarë arsye, tifozit Mehmet Gashi, 20 vjeçar, derisa ky i fundit, pa e ofenduar askënd, po e festonte fitoren e ekipit të tij, me rënie daulle.

Rreshteri Kryeziu e urdhëroi atë fillimisht ta ndërpresë festën dhe pasi që ky e ndali festën e tij, rënies së daulles, ai urdhëroi arrestimin. Prapë, pa asnjë shkas duke iu vërsulur edhe fizikisht atij.

Reaguan edhe tifozët e tjerë të Hajvalisë. I vetëdijshëm që aty kishte edhe policë të tjerë të minoritetit serb, unë insistova që të qetësohet situata, tifozit të përgjakur, pas goditjeve të papritura të policit Kryeziu, i kërkova të ruajë gjakftohtësinë dhe ta lejojë arrestimin e tij nga policia. Isha i vetëdijshëm se polici nuk kishte të drejtë, tifozëve iu kërkova ta ruajnë gjakftohtësinë.

Derisa po tentoja qetësimin e situatës, pa pritur hasa në kërcënimin e rreshterit Kryeziu për arrestim edhe ndaj meje. Nuk ndërhyra në punë të policisë, po atë natë edhe të nesërmen, për sjellje të pahijshme dhe tejkalim të autorizimeve të tij si polic, e denoncova rreshterin në stacionin e policisë - Qendra.

Po ashtu denoncimin e kam bërë edhe në Inspektoratin Policor të Kosovës dhe shkresën për një njoftim ia kam adresuar ministrit të Rendit dhe drejtorit të përgjithshëm të Policisë së Kosovës.

Sipas informatave shtesë mirë të konfirmuara, rreshteri Kryeziu nuk ka qenë i caktuar të jetë prezent në atë aktivitet sportiv, ai ka shkuar atje me qëllime për të krijuar tensione dhe për nxitje incidente.

Rreshteri Ramë Kryeziu, ka synuar, me po të njëjtën mënyrë, të provokojë tifozë dhe ka nxitje incidente së paku edhe në dy takime të tjera, në atë midis klubit të Hajvalisë dhe të atij "Ballkanit" të Suharekës dhe në atë midis klubit të Hajvalisë dhe klubit të Deçanit. Këtë e dëshmojnë tifozët dhe xhirimet e Federatës së Futbollit të Kosovës.

Fatmirësisht, në asnjërin rast, tifozët nuk kanë rënë në grackën e tij për të sulmuar Policinë e Kosovës, që ka strukturë multietnike në atë komunë.

Nuk janë të rastit ndërhyrjet e këtij rreshteri për të nxitur incidente në futboll, pikërisht në kohën kur Kosova synon të krijojë imazh të mirë në këtë sport për t'u pranuar në mekanizmat ndërkombëtarë të UEFA-s e FIF-as.

I njëjti pjesëtar i Policisë së Kosovës, i diplomuar në fund të viteve 90-ta në Akademinë Policore të Beogradit, i kthyer në Kosovë pas vitit 1999, ka nxitur dhe inskenuar edhe raste të tjera, me qëllim krijimit të incidenteve dhe tensioneve ndëretnike.

Të nderuar kolegë deputetë,

Besoj se secili nga ne mund ta marrë me mend se çka mund t'i kishte ndodhur këtij polici, për shembull në vitin 1999, kur ky ishte duke punuar nën uniformën e Policisë Serbe në Beograd, sikur të krijonte një incident në cilindo nga stadiumet e futbollit atje, siç e ka krijuar më 2 nëntor në stadiumin e Kishnicës me daullagjinë e simpatizantëve vendas? Sjellja e tij mund t'i shërbejë bartjes së tensioneve ndëretnike nga veriu në qendër të Kosovës, veçanërisht në kohën kur në veri po përballemi me tensione dhe barrikada.

Fakte të mësipërme dhe rastin në të cilin unë isha dëshmitar e dëshmojnë më së miri këtë.

Konsideroj se institucionet e Kosovës, veçanërisht mekanizmat e rendit dhe të sigurisë, duhet të jenë më vigjilent në filtrimin e strukturave të tyre, në identifikimin e personave qëllimkëqij të cilësdo përkatësie etnike qofshin ata dhe që pameritueshëm e bartin uniformën....

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARI: Hajt, vazhdoje.

Regjia vazhdoje fjalën, 2 minuta.

RAMIZ LADROVCI:... duke respektuar uniformën e Policisë së Kosovës. Rreshteri Ramë Kryeziu, duke qenë ende në detyrë, ai mund të influencojë në hetimet. Gjithashtu, sipas të gjitha informatave që kam siguruar pas këtij rasti, qytetarët e Hajvalisë jetojnë vazhdimisht në tmerrin e presionit të vazhdueshëm që pa të drejtë ua bënë kurdo dhe kudo që i teket rreshterit Ramë Kryeziu. Jo vetëm tifozët, por të gjithë qytetarët e asaj zone, janë në trysinë e vazhdueshme të atij rreshteri.

Në fund inkurajoj qytetarët e atij lokaliteti dhe të gjithë vendit, që t'i denoncojnë në organet disiplinore të Policisë së Kosovës, të gjitha veprimet e pahijshme të atyre pjesëtarëve të Policisë, që përlyen uniformën e respektuar të Policisë së Kosovës, që i tejkalojnë kompetencat dhe përgjegjësitë e tyre. Ata që janë të ftuar të ruajnë rendin, nuk duhet të shkelin atë. Disa individë nuk kanë të drejtë ta njollosin institucionin e sidomos institucionin e shenjtë të ruajtjes së rendit. Ju faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!

Në emër të Grupit Parlamentar Koalicioni për Kosovë të Re, Gëzim Kelmendi e ka kërkuar fjalën.

GËZIM KELMENDI: Faleminderit!

I nderuar kryetar i Kuvendit,

I nderuar kryeministër,

Të nderuar zëvendëskryeministra dhe ministra,

Kolegë deputetë dhe deputete të nderuar,

Pa dyshim që ndër prioritetet tona mbetet rritja dhe zhvillimi ekonomik dhe i mirëqenies së qytetarëve të Kosovës, por përballë kësaj sfide ne nuk guxojmë që në asnjë formë që për t'i realizuar synimet dhe prioritetet tona, të rëndojmë situatën e atyre që vite me radhë e kanë bartur peshën e rritjes së zhvillimit ekonomik.

Ne jemi të vetëdijshëm që kontribuuesit më të mëdhenj kanë qenë dhe vazhdojnë të jenë bizneset e vogla dhe bizneset e mëdha, që janë një ndër taksapaguesit më të mëdhenj të Republikës së Kosovës, por ajo që viteve të fundit i ka rënduar ata është vendimi i tyre për blerjen e arkave fiskale.

Nuk dua të ketë keqkuptime, as unë dhe as ata, nuk jemi kundër arkave fiskale, por jemi kundër strategjisë se këto arka t'u imponohen atyre. Çmimet e larta që ata janë detyruar t'i paguajnë për këto arka fiskale, pa dyshim që edhe më shumë e rëndojnë statusin e tyre ekonomik dhe biznesor.

Nga kjo strategji e shitblerjes së arkave fiskale, fitimtare nuk është as Qeveria e Kosovës, as bizneset, por janë ato kompani të cilat e kanë fituar të drejtën e shitjes së këtyre arkave fiskale.

Çmimet e larta të këtyre arkave fiskale dhe gjithashtu kamatat e larta në rast të blerjes së këtyre arkave me këste, kanë ndikuar që nga numri i përgjithshëm i bizneseve që janë regjistruar në Republikën e Kosovës, 105 mijë, deri tani vetëm 9 mijë janë pajisur me këto arka.

Një vërejtje të tillë e kemi pasur edhe në Raportin e Progresit, ku një gjë të tillë mjaftë mirë dhe në mënyrë profesionale e ka elaboruar deputeti i nderuar Ali Sadriu.

Nuk janë vetëm çmimet e larta të këtyre arkave fiskale të cilat e bëjnë edhe më të rëndë këtë, por fakt tjetër me rëndësi që rëndon situatën e bizneseve kosovare është edhe fakti se këtyre bizneseve u imponohet që çdo vit të bëjnë servisimin e këtyre arkave, në vlerë prej 116 eurove. Do të thotë, nëse nuk bëhet kjo pagesë atëherë atyre u bllokohet funksionimi i këtyre arkave fiskale.

I nderuar ministër Hamza,

Unë jam plotësisht i vetëdijshëm që në mandatin e kaluar ju nuk keni qenë pjesë e kësaj Qeverie, por duke pasur parasysh qysh në fillim të mandatit jeni përkushtuar për rritje dhe zhvillim të ekonomisë dhe lehtësime bizneseve, kam arsye dhe besim të fortë të shpresoj që ju nuk do të lejoni edhe më tutje të rëndohet gjendja e bizneseve kosovare, ku fitues nga kjo situatë janë vetëm kompanitë të cilat e kanë fituar të drejtën e shitjes së këtyre arkave. Faleminderit!

KRYETARI: Fjalën e ka deputeti Naser Osmani.

NASER OSMANI: Faleminderit, kryetar!

Fjala ime sot do t' ju drejtohet juve në kuptimin e sugjerimit lidhur me Qendrën Protokollare.

Me qenë se para do dite isha fizikisht për ta parë një investim që e ka filluar Kuvendi, goxha moti dhe ajo që pashë është dëshpëruese, pasi që ka tendencë të degradimit të atij investimi që është bërë deri më tani dhe është frika që ato investime të deritashme të humbin.

Me qenë se është diskutuar gjatë lidhur me këtë qendër, Kuvendi më 17 korrik 2006, ka mbajtur një seancë plenare, ka prurë një vendim dhe pas atij vendimi që është prurë që të vazhdohet kjo qendër protokollare, nuk ka ndonjë vendim tjetër. E derisa nuk ka ndonjë vendim tjetër dhe me qenë se jemi tash në prag të hartimit të buxhetit për vitin 2012, si kryetar ju kisha sugjeruar që ta keni në konsideratë që të vazhdojë investimi, që të ndërtohet Qendra Protokollare dhe pasi të ndërtohet, atëherë Kuvendi të marrë një vendim për shfrytëzimin e atij objekti dhe mënyrën e shfrytëzimit, po ju kisha sugjeruar që ta urdhëroni sekretarinë që ta parasheh si pozicion edhe në Komisionin për Buxhet dhe Financa, ta kemi parasysh që të vazhdohet më tutje puna në kuptimin e asaj që të mos humbin ato investime të cilat janë bërë deri më tani. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!

Për këtë çështje mendoj se në seancën e radhës do të marrë një vendim tjetër Kuvendi.

Vazhdojmë, në emër të Grupit Parlamentar të “Vetëvendosjes” deputeti Glauk Konjufca e ka fjalën.

GLAUK KONJUFCA: Të nderuar deputetë,

Fundi i muajit tetor dhe fillimi i këtij muaji, në Gjilan, sollën në diskutim gjithandej çështjen e përmendores së dy dëshmorëve: Rexhep Mala e Nuhi Berisha, të cilët ranë më 12 shkurt të vitit 1984, në përleshje të drejtpërdrejtë me forcat policore jugosllave, në Prishtinë.

Këtyre dy dëshmorëve, të cilët ligjet e Kosovës nuk i njohin për të tillë, por qytetarët e saj i çmojnë edhe më lart, Kuvendi komunal në Gjilan, me vendimin e tij numër 01-3788/020 të 29 prill 2004, bazuar edhe në projektin urbanistik, ua vendosi përmendoren në sheshin qendror të qytetit të Gjilanit.

Por e tmerrshmja ndodhi kur më 27 tetor 2011, Komiteti Komunal për Politikë e Financa në Gjilan, me rekomandim të kryetarit të komunës, Qemajl Mustafa, mori vendimin t'i propozojë Kuvendit komunal, që në mbledhjen e tij më 4 nëntor, të marrë vendim për zhvendosjen e përmendores së dëshmorëve Rexhep Mala e Nuhi Berisha, gjë që ky komitet e bëri dhe me ç'rast dakord ishin të gjithë shefat e grupeve të këshilltarëve komunalë, përpos atij të AKR-së.

Si rrjedhojë në rendin e ditës për mbledhjen e Kuvendit Komunal në Gjilan, të publikuar më datë 27 tetor, si pikë e dytë figuronte- Shqyrtim- miratimi i kërkesës për dislokimin e përmendores- Rexhep Mala dhe Nuhi Berisha, e vendosur në hapësirën e Hotelit “Kristal”. Pra, përpos që u fut në rend të dite kjo pikë ashtu shpejtë e shpejtë dhe qetë, aty thuhet- shqyrtim miratimi, pra paragjykohej miratimi i kësaj kërkesë dhe tjetra që ishte skandaloze, sheshi ku ndodhet sot përmendorja e dëshmorëve, trajtohet si hapësira e hotelit “Kristalit” ndërkohë që ky shesh quhet Sheshi Rexhep Mala e Nuhi Berisha.

Në kohën kur u vu përmendorja ky ishte një shesh publik dhe kjo do të duhej të trajtohej dhe të gjendej përgjigje se si u bë që sheshi publik të kalojë në pronë të Hotel “ Kristalit” i cili kërkon zgjerimin dhe zënien e hapësirës?

Ashtu si u fut në rend të ditës shpejtë e shpejtë dhe qetë, ashtu edhe u tentua të miratohej, hoteli do të zgjerohej, hapësira publike do të ngushtohej. Të shkathët janë ata dhe shpejtë e qetë do të ndodhte, por ishin reagimet e shpejta dhe aspak të qeta qytetare, ato që e bënë kryetarin e Gjilanit ta tërhiqte nga rendi i ditës këtë shqyrtim dhe miratim.

Ai sot ende po deklaron se është i vendosur për dislokimin e përmendores dhe ne e dimë që tani për tani nuk do të ketë tentativa serioze për heqjen e kësaj përmendore, pasi pushteti llogarit që të përleshet me qytetarët. Por, do të doja të paralajmëroja që edhe tani për tani edhe në të ardhmen, do të ketë qytetarë që do të jenë aty me çdo kusht, po që se dikush tenton ta prekë përmendoren dhe historinë e shqiptarëve në përpjekjet e tyre për liri.

KRYETARI: Faleminderit!
Deputeti Agim Kuleta e ka fjalën.

AGIM KULETA: Faleminderit, zoti kryetar!
Deputetë të nderuar,

Në seancën e 26 tetorit, pra në seancën ku ishte i ftuar kryeministri për interpelancë, në fjalimin e fundit të kësaj seance lëvizja “Vetëvendosje” mbajti një fjalim, një deklaratë të çuditshme, një deklaratë pa sens konsideroj fyese dhe denigruese për shumë subjekte këto. Në radhë të parë e konsideroj që është fyese, sepse duke i cilësuar dhe duke i klasifikuar me terma të ndryshme çdo subjekt, shumë subjekte politike këtu, në fund e konsideroj të arsyeshme t’ua kërkojë edhe votën. Ndërsa, arsyeja pse unë kam dalë këtu, arsyeja më e fuqishme dhe kryesore, është atakimi që iu ka bërë drejtpërdrejt subjektit të cilit i takoj unë.

Glauk Konjufca, saktësisht thotë që – mendoj se Lëvizja për Bashkim e ka shumë të kollajshme zgjidhjen e veriut të Kosovës, sepse më lehtë është për t’ia dhënë Serbisë.

Lëvizja për Bashkim e ka një platformë politike për zgjidhjen e problemit shqiptaro-serb edhe Glauku e njej shumë mirë atë platformë, kemi biseduar bashkë rreth asaj platforme dhe e di shumë mirë që kjo që ka thënë këtu nuk është e saktë. Unë nuk e di motivin pse e ka thënë dhe më ka ardhur shumë e çuditshme prej anës së tij.

Në këtë platformë, Lëvizja për Bashkim nuk e vendos territorin, por e vendos njeriun, të drejtat e tij dhe vullnetin e tij për të jetuar ashtu si të dojë dhe ku të dojë. Prandaj, në bazë të kësaj, në këtë prizëm e sheh edhe zgjidhjen e problemit shqiptaro-serb, pra zgjidhjen e problemit të veriut dhe të Kosovës Lindore. Të drejtat që u njihen serbëve në tri komunat e Kosovës, të banuara me serbë, t’u njihen edhe shqiptarëve që jetojnë në Kosovën Lindore, prandaj këtu nuk besoj se ka vend për të bërë një konstatim të tillë siç është dhënia e territorit Serbisë.

Unë jam i prirë t'i mirëkuptoj njerëzit tanë, andaj unë në qoftë se do të ishte ky një gabim i momentit, unë do ta kërkoja tërheqjen e kësaj deklarate nga "Vetëvendosja", përndryshe, në qoftë se nuk ndodh kjo, atëherë kjo shihet që është një manipulim, me qëllim denigrues. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Fjalën e ka deputeti Zenun Pajaziti.

ZENUN PAJAZITI: Faleminderit, zoti kryetar!

I nderuar kryeministër,

Kabinet qeveritar,

Më lejoni që sot ta shtroj një çështje për të cilën unë sot zyrtarisht kam nisur edhe një letër tek ju, zoti kryetar i Kuvendit, që ka të bëjë me Komisionin Kosovar të Konkurrencës.

Ne, si Komision e kemi bërë një monitorim dhe një vëzhgim të punës së këtyre agjencive që janë nën mbikëqyrjen e komisionit tonë dhe kemi arritur në përfundim që duhet urgjentisht Kuvendi të marrë masa që ky komision të dalë, t'i bëhet zgjidhje e qëndrimit pra me zyrat tjera, qoftë të përkohshme, njëherë derisa të bëhet zgjidhje përfundimtare me objektet e tyre. Po ashtu është mirë, sepse është edhe koha kur planifikohet buxheti dhe do të jetë vonë nëse shtyhet kjo, ai komision është me një dy zyra të ngushta dhe nuk ka mundësi që të rekrutojë zyrtarë, të cilat edhe me Raport të Progresit i drejtohen.

Po ashtu do të ishte mirë që në bashkëpunim me Qeverinë të bëjmë shqyrtimin e punës së gjitha agjencioneve, sepse kemi edhe çështje që kanë të bëjnë me ndryshimin e ligjeve dhe po ashtu edhe me çështje të tjera operationale të funksionimi të këtyre komisioneve.

Dhe, më lejoni, meqenëse këtu u shtrua edhe një çështje nga deputeti i "Vetëvendosjes" për çështjen e shtatores së heronjve në Gjilan, t'ju them se janë krejtësisht të pavërteta ato që shtrohen këtu dhe është po ashtu e pandershme që të shfrytëzohen këto raste për qëllime politike. Unë dëshiroj t'ju them se ka qenë një kërkesë në Gjilan nga një biznes privat, meqenëse në pronën e tij të ligjshme ndodhet një shtatore, e cila është vendosur kohë më parë nga njerëzit – qytetarët nga vetë shoqatat në Gjilan, një shtatore e cila është e pranuar nga të gjithë qytetarët e Gjilanit. Dëshiroj t'ju them që me kontributin e vet kryetarit të Gjilanit, kryetarit të Partisë Demokratike në Gjilan dhe deputetëve të Partisë Demokratike, kjo çështje ka arritur të trajtohet bashkërisht dhe të mos qitet në seancë, të shtyhet për një kohë tjetër, ku ka ide shumë të mira të kryetarit të Gjilanit dhe të udhëheqjes atje që i gjithë sheshi i qytetit të riorganizohet në kuptimin edhe të rindërtimit, po edhe të pozicionit të shtatoreve dhe të monumenteve historike që janë të rëndësishme dhe të pranuar nga qytetarët e Gjilanit.

Dëshiroj t'ju them që ka plane jashtëzakonisht të mira dhe ato monumente do të trajtohen, do të ruhen nga institucionet komunale, nga vetë qytetarët e Gjilanit, nuk do të ketë nevojë fare që të manipulohen situata të tilla politikisht nga cilado parti politike qoftë.

Dëshiroj të them që kanë qenë krejt të panevojshme ato veprime, manipulimi i qytetarëve në rrugë, meqenëse Kuvendi komunal i Gjilanit nuk ka marrë asnjë vendim.

Dëshiroj po ashtu ta falënderoj kryetarin e Gjilanit, i cili na ka konsultuar të gjithë neve, edhe qytetarët e Gjilanit dhe nuk ka lejuar që kjo çështje të bëhet temë e përçarjes...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARI: Faleminderit!

Fjalën e ka deputetja Vjosa Osmani.

E keni parasysh, pika e rendit të ditës është për deklarime jashtë rendit të ditës.

VJOSA OSMANI: Faleminderit, kryetar!

Të nderuar deputetë,

Kabinet qeveritar,

Arsyeja pse sot po e ngre këtë çështje është, sepse rrugës për Prishtinë pashë shumë tabela: KM, GL, PR e shumë të tjera. Të gjithë ne e dimë që data për fillimin e zbatimit të disa nga marrëveshjet që janë arritur në mes Kosovës dhe Serbisë, edhe pse ato nga Qeveria shpesh janë quajtur konkluzë, ka qenë data 1 nëntor.

Edhe pse Kosova njëanshëm ka filluar zbatimin e asaj marrëveshjeje dhe po i përkujton qytetarët e Kosovës, përmes reklamave televizive se ka bërë kthim prapa në kohën e UNMIK-ut, duke përdorur tabela KS, serbët po vazhdojnë përdorimin e tabelave serbe në Kosovë, edhe pse nga data 1 nëntor, do të thotë 10 ditë më parë, është dashur që këto tabela të fillojnë të shpallen ilegale.

E njëjta po ndodh edhe me marrëveshjet për lëvizjen e lirë të qytetarëve të dy vendeve. Kosova ka filluar zbatimin e njëanshëm të kësaj marrëveshjeje për qytetarët serbë, duke i lejuar ata të hyjnë në Kosovë vetëm me letërnjoftime, por kjo nuk po vlen edhe për kosovarët që duan të hyjnë në Serbi, me dokumente shtetërore të Kosovës. Madje, autoritetet e Kosovës po e arsyetojnë Serbinë për këtë vonesë duke thënë se vonesa u bë për shkak se Serbia nuk ka bërë përgatitjet e duhura.

Ndoshta nuk ka pasur kohë t'i bëjë këto përgatitje, për shkak se ka qenë shumë e zënë me krijimin e tenseve në veri, me financimin dhe nxitjen e strukturave paralele, por nuk besoj që është e arsyeshme nga ana e palës kosovare që të sillet thuaja se asgjë nuk po ndodhë dhe ta arsyetojë Serbinë duke thënë që implementimi do të fillojë pasi ta hartojmë planin e implementimit, e pas hartimit të planit të implementimit, do të hartojmë edhe planin e zbatimit të këtij plani dhe kështu të krijohen vonesa të paarsyeshme, derisa dialogu po thuhet se do të vazhdojë pa kurrfarë problemi, Serbia, pa zbatimin e këtyre marrëveshjeve, po fiton statusin e kandidatit, ndërkaq Kosova nuk po kërkon karotën e vet në këto bisedime dhe besoj se koha ka ardhur që të tregohet më e përgjegjshme Qeveria e Kosovës, në këtë proces. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!

Diskutuesi i fundit për sot është deputeti Liburn Aliu.

LIBURN ALIU: Nuk pata në plan të diskutoj, por po lidhem prapë me përmendoren e dëshmorëve: Rexhep Mala e Nuhi Berisha, për atë se çka tha Glauku, u deklarua që është e pavërtetë.

Me datën 27 tetor 2011, Komiteti komunal për Politikë e Financa në Gjilan ka mbajtur mbledhje dhe ka vendosur që t'i rekomandojë Kuvendit komunal ta heqë atë.

Këtu u tha që, për hir të një plani të një zgjerimi dhe rregullimit të sheshit, duhet të hiqet ajo. Duhet ta kemi parasysh një gjë. Ka plan urbanistik dhe në bazë të atij plani urbanistik në vitin 2004, është vendosur ajo shtatore. Pra, nëse vendoset të hiqet, ajo duhet bërë pasi që të bëhet një plan, të bëhet plani urbanistik, të rregullohet sheshi, të merret vendim për një plan të ri urbanistik për atë shesh dhe më pastaj do të mund të vendoset. Po kështu, vendimi për ta hequr atë, duke u bazuar thjesht nga kërkesa e pronarit të Hotelit "Kristal" është plotësisht në kundërshtim me edhe me rregullat urbanistike, është në kundërshtim edhe me ndjenjat e shqiptarëve në Gjilan.

KRYETARI: Faleminderit!

Po ta kemi parasysh se kjo pikë e rendit të ditës nuk është debat, është deklarime të lira dhe jashtë rendit të ditës.

Nga seanca e kaluar ka mbetur votimi për rekomandimet e Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike lidhur me Raportin e Progresit për Kosovën 2011.

Fjalën ia kisha dhënë kryetarit të Grupit, deputetit Ismet Beqiri, që të na njoftojë dhe i ka harmonizuar këto edhe me grupet parlamentare.

ISMET BEQIRI: Faleminderit, zoti kryetar!

Ne edhe me kolegët e grupeve tjera parlamentare, në seancën e kaluar, i prezantuam si grup parlamentar dhe me dy vërejtje të vogla që kanë qenë nga Partia Demokratike, të inkorporuara në këtë tekst, unë po ua lexoj edhe një herë rekomandimet dhe sigurisht në fund do të kërkoja që deputetët e nderuar t'i votojnë.

Në mbështetje të nenit 65 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe bazuar në Rregulloren e Punës të Kuvendit, Kuvendi i Republikës së Kosovës, në debatin mbi Raportin e Progresit, në seancën plenare, ka qenë domethënë me datën 8, tash jemi sot më 11 nëntor, me propozim të Grupit Parlamentar dhe në marrëveshje edhe me grupet tjera, miratoi këto

REKOMANDIME

Për plotësimin e kërkesave nga Raporti i Progresit 2011

- Duke marrë në konsideratë të gjeturat e paraqitura në Raportin e Progresit për Kosovën 2011, të Komisionit Evropian;
- Duke rikonfirmuar përkushtimin e qytetarëve të Kosovës ndaj procesit të integritetit evropian;
- Duke synuar përmbushjen e kritereve politike, ekonomike dhe standardeve evropiane si kusht kryesor për integritet evropian,

Kuvendi i Republikës së Kosovës,

1. Vlerëson se duhet të intensifikohen reformat në të gjitha fushat e shoqërisë, sidomos në reformën zgjedhore, e cila do të mundësojë legjitimitetin e plotë të institucioneve të ardhshme të vendit, të sigurohet sundimi i ligjit dhe shteti i së drejtës në plotësi në tërë territorin e vendit, të zbatohen reformat ekonomike, të cilat do të mundësojnë një zhvillim të diversifikueshëm, punësim dhe qëndrueshmëri buxhetore, të reformohet administrata publike dhe të rritet përgjegjësia dhe efikasiteti i saj.
2. Kuvendi i Republikës së Kosovës të angazhohet për përgatitjen dhe aprovimin e ligjeve të domosdoshme për të gjitha reformat politike, ekonomike dhe sociale, për monitorim të vazhdueshëm dhe intensiv të punës dhe të veprimeve të Qeverisë.
3. Qeveria e Republikës së Kosovës të përgatitë Programin veprues në bazë të gjeturave, fakteve dhe analizave nga Raporti i Progresit. Me këtë program Qeveria duhet të marrë përgjegjësi të afatizuara për të siguruar sundimin e ligjit, eliminimin e korrupsionit dhe krimit të organizuar, politika nxitëse për zhvillimin e sektorit privat, për rritje ekonomike dhe punësim, qeverisje të përgjegjshme kooperative të kompanive publike, reformim të prokurimit, kontroll të shpenzimeve publike dhe qëndrueshmëri afatgjate buxhetore, duke respektuar detyrimet ndërkombëtare, të sigurojë mos ndikimin politik në institucionet e pavarura, mediave dhe administratë, të sigurohet një sinergji e Kuvendit dhe komisioneve të tij, të Qeverisë dhe ministrive përkatëse, komunave dhe shoqërisë civile për bashkërenditje të veprimeve për plotësimin e të gjitha kriterëve dhe kërkesave në fushën politike, ekonomike dhe sociale, të cilat bashkësia ndërkombëtare i shtron para Kosovës për integrimin evropian dhe euro-atlantik.
4. Kuvendi i Republikës së Kosovës do të trajtojë në çdo tremujor progresin, plotësimin e kërkesave nga Raporti i Progresit dhe ta adresojë përgjegjësinë ndaj institucioneve të Republikës së Kosovës.

Këto ishin ato rekomandime, zoti kryetar, dhe besoj se do të jenë pjesë e planit veprues edhe të Qeverisë, por edhe të Kuvendit të Republikës së Kosovës, në të ardhmen. Faleminderit!

KRYETARI: A jeni dakord ju shefat e grupeve parlamentare për këtë?

Dakord!

Atëherë, shkojmë me procedurën e votimit.

Regjia, le të përgatitet t'i votojmë rekomandimet e propozuara nga Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike lidhur me Raportin e Progresit për Kosovën, për vitin 2011. Votojmë tash.

Me 72 vota “për”, 3 “kundër”, 2 “abstenime”, Kuvendi miratoi rekomandimet e propozuara nga Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike.

Para se të vazhdojmë me rendin e ditës, në konsultë me kryetarët e grupeve parlamentare, pika 13 e rendit të ditës, për faktin se lënda është në Gjykatën Kushtetuese, që Kuvendi mos të bëjë interferim në këtë lëndë, shtyhet ose hiqet nga rendi i ditës për seancën e sotme.

Komisioni, a e do fjalën? Jo.

Atëherë, kërkohet një deklaram i seancës.

Kush është për këtë propozim, me ngritje dore? Faleminderit!

A ka kundër? A ka abstenim? Faleminderit!

Me shumicë të votave, pika e fundit e rendit të ditës hiqet nga shqyrtimi.

Në radhë kemi pikën dytë të rendit të ditës:

2. Koha për pyetjet parlamentare

Në pajtim me nenin 45, pika 1 të Rregullores së Kuvendit, koha për pyetjet e deputetëve për Qeverinë është e kufizuar në 60 minuta. Deputetët në një mbledhje mund t'i parashtrojnë më së shumti dy pyetje parlamentare.

Deputeti Shaip Muja nuk është këtu.

Deputetja Aurora Bakalli, pyetje për ministrin Ferid Agani.

Deputete, e ke fjalën!

AURORA BAKALLI: Faleminderit, zoti kryetar!

Ditëve të fundit punëtorët e Qendrës Klinike Universitare të Kosovës kanë reaguar ndaj një vendimi për parapagim të rregullt mujor në parkingjet e Qendrës Klinike Universitare të Kosovës, gjegjësisht në vendet e tyre të punës.

Ky vendim është marrë pas dhënies me konsension të parkingut të QKUK-ës një kompanie private.

Bazuar në praktikat më të mira ndërkombëtare, për partneritet publiko-privat, dihet që gjatë përgatitjes së konsensioneve është e domosdoshme që të konsultohen të gjitha palët e interesit.

Më intereson të di, pse nuk është konsultuar fare Sindikata e punëtorëve të QKUK-ës gjatë përgatitjes së këtij partneriteti publiko-privat, si palë e cila preket direkt nga ky konsension dhe a ka pasur ky projekt një studim paraprak të fizibilitetit dhe një analizë të qëndrueshme bankare? Faleminderit!

KRYETARI: Ministër, e ke fjalën!

MINISTRI FERID AGANI: I nderuar kryetar i Kuvendit,
I nderuar zoti kryeministër,
Zëvendëskryeministra, ministra,
Të nderuar zonja dhe zotërinj deputetë,
E nderuara deputete, ju e dini mirë çështjen e parkingjeve të stërmbytura në Qendrën Klinike Universitare, problemin e jashtëzakonshëm me qasje në Qendrën Emergjente të Klinikës Universitare të Kosovës, qasjen deri në klinikat tjera të këtij institucioni që ka zgjatur me vite të tëra.

Nga ana tjetër, është i mirënjohur fakti se Ministria e Shëndetësisë është e vetmja e cila e ka nënshkruar një kontratë sektoriale me Sindikatën e punëtorëve shëndetësorë dhe në këtë drejtim e ka formuar edhe një grup të veçantë për zbatimin, për mbikëqyrjen e zbatimit të kësaj kontrate i cili është duke punuar në mënyrë të rregullt.

Mendoj se në rastin konkret, nuk është bërë fjalë për shkelje të kësaj kontrate sektoriale, duke konsideruar se Sindikata e pavarur e punëtorëve shëndetësorë të Qendrës Klinike Universitare të Kosovës, ka pasur për detyrë parësore të merret në mbrojtjen dhe avancimin e të drejtave të punëtorëve që dalin nga kontrata e punës së tyre me Qendrën Klinike Universitare të Kosovës e jo me menaxhimin e hapësirave publike dhe parkingut dhe përkitazi me këtë çështje nuk është parë se ka bazë ligjore se duhet konsultuar me ta për këtë çështje.

Sa i përket studimit të fizibilitetit, duke pasur para sysh gjendjen emergjente në Qendrën Klinike Universitare, sa i përket kësaj çështjeje, nuk është parë po ashtu në konsultim me autoritetet përkatëse dhe në bazë të ligjit arsyeja që të hyhet, të ketë edhe një studim të veçantë të fizibilitetit përkitazi me këtë çështje. Ajo që është bërë nga administrata e Ministrisë së Shëndetësisë është se është marrë parasysh niveli i inkasimit vjetor nga të hyrat e automjeteve dhe është caktuar trefishi i këtyre mjeteve për investim nga konsensionari.

Ndërsa, te termi i analizës së qëndrueshmërisë bankare, në këtë rast, mendoj se është i përdorur gabimisht dhe se nuk ka të bëjë me këtë projekt, sepse është diçka që ka të bëjë më tepër me investime të veçanta në lëmin e caktuar. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, ministër!
Deputete, a ke pyetje shtesë?

AURORA BAKALLI: Sindikata e Punëtorëve, gjegjësisht përfaqësuesit e punëtorëve është dashur të konsultohen pasi ata preken direkt, do të thotë, punëtorët do të duhet të paguajnë për parkingjet në vendet e tyre të punës. Domethënë, ju lutem, zoti ministër, nëse ekziston të paktën edhe një organizatë në Kosovë, qoftë publike apo private ku punëtorët duhet të paguajnë në vendin e tyre të punës, në parking.

Në anën tjetër, sa i përket studimit të fizibilitetit, analizës së fizibilitetit, mendoj se është dashur të bëhet, sepse me një llogaritje të thjeshtë nëse bëhet prej numrit të punëtorëve,

sa mendoni të inkasoni, më shumë se do të nxirren investimet në periudhën trevjeçare, çfarë do të ndodhë me mjetet e tjera, nga do të shkojnë ato, a do të shkojë një pjesë, a do t'i dedikohet QKUK-ës apo do t'i shkojnë kompanisë private? Prandaj, është dashur të bëhet analiza e fizibilitetit, sepse është e vërtetë ajo që thatë, parkingjet janë të stërngarkuara nga punëtorët shëndetësorë dhe nga një numër tepër i madh i palëve të cilat për çdo ditë...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARI: Ministër, a e do fjalën?

MINISTRI FERID AGANI: E nderuara deputete, Interesi parësor i Ministrisë së Shëndetësisë ka qenë zgjidhja e problemit akut emergjent të qasjes së pacientëve deri te institucionet shëndetësore. Kjo është e para dhe kryesorja.

E dyta, punëtorët shëndetësorë i kanë të drejtat e tyre që u dalin nga kontrata e punës dhe në këtë kontratë nuk është paraparë që ata do të kenë hyrje deri te institucioni ku punojnë, pa pagesë.

E treta, në të gjitha institucionet qeveritare, përfshirë Ministrinë e Shëndetësisë dhe parkingjet e tyre, punëtorët e vet këtyre institucioneve nuk kanë qasje në parkingje, pa pagesë.

Prandaj, ka shembuj të shumtë në këtë aspekt, sepse interesi parësor është interesi i institucionit dhe interesi në këtë rast tonin i punëtorëve shëndetësorë.

Kur është në pyetje çështja e studimit të fizibilitetit, unë duke treguar një ndjeshmëri politike rreth kësaj çështjeje, unë megjithatë pas ngritjes së çështjes nga sindikata e punëtorëve shëndetësorë të Qendrës Klinike Universitare të Kosovës e kam angazhuar edhe Zyrën e Auditorit të Brendshëm në Ministrinë e Shëndetësisë, që edhe një herë të shqyrtojë tërë lëndën dhe përkitazi me këtë do të kemi një raport zyrtar. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, ministër!

Deputeti Salih Morina, pyetje për ministrin Bedri Hamza.

Deputet, e ke fjalën.

SALIH MORINA: Faleminderit, kryetar!

I nderuar kabinet qeveritar,

I nderuar ministër Hamza,

Kam një pyetje në lidhje me deklaratat financiare. Do të thotë, sa merren parasysh deklaratat financiare në Qeveri lidhur me miratimin e ligjeve, kur dihet që në këtë vit do të thotë kemi një mori ligjesh, për të cilat është kërkuar nga Departamenti i Buxhetit, që për shkak të implikimeve të mëdha buxhetore këto ligje t'i kthehen Qeverisë dhe do të thotë se një numër i konsiderueshëm i tyre janë aprovuar në leximin e parë dhe po ashtu një numër i tyre kanë kaluar në leximin e dytë?

Prandaj, ju si përgjegjës i Ministrisë për Ekonomi e Financa, duke llogaritur edhe në Rregulloren e Parlamentit të nenit 54, i cili thotë se çdo ligj duhet ta ketë buxhetin sidomos për vitin e parë dhe pastaj edhe për vitet në vijim, ndërsa kemi edhe ligje të cilat janë aprovuar në Parlament dhe buxheti sipas deklaratës financiare, do të thotë, është paraqitur për implementim të shkohet pas vitit 2015 dhe njëkohësisht kemi ligje të cilat nuk janë në kornizën afatmesme 2012 – 2014. Prandaj e kërkoj një përgjigje, zoti ministër.

KRYETARI: Ministër, e ke fjalën!

MINISTRI BEDRI HAMZA: I nderuar kryetar i Kuvendit,
I nderuar zoti kryeministër,
Zëvendëskryeministra, ministra,
Deputetë të nderuar,
I nderuari deputet Morina, faleminderit për pyetjen!
Qeveria e Republikës së Kosovës po inkurajon përdorimin e vlerësimit të ndikimit përmes legjislacionit që e ka aprovuar dhe që është pjesë e procedurave të vendimeve të Qeverisë.

Baza ligjore për vlerësimin e ndikimit buxhetor apo deklarata financiare është neni 9 i Ligjit numër 03/L-221 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit numër 03/L-048 për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë dhe Rregullorja e punës së Qeverisë së Kosovës, numër 09-2011.

Më lejoni t'ju njoftoj se Ministria e Financave me rastin e hartimit të legjislacionit është pjesëmarrëse e grupeve punuese në nivel të Qeverisë. Është e natyrshme se përmes këtij përfaqësimi ne synojmë që i gjithë legjislacioni të hartohet që në fazën e parë brenda kuadrit ekonomik dhe buxhetor që e ka Qeveria e Republikës së Kosovës.

Në rend të parë, përgjegjës për përgatitjen e deklaratës financiare janë organizatat buxhetore sponzoruese të legjislacionit. Megjithatë, për të qenë sa më objektiv, ky vlerësim financiar Ministria e Financave po ashtu i paraqet opinionin e saj për vlerësimin financiar të projektligjeve dhe këto vlerësime bëhen pjesë e dokumentit së bashku me Projektligjin gjatë shqyrtimit në Qeveri.

Është e rëndësishme se tani thuaja nuk asnjë projektligj që diskutohet në Qeveri, pa një opinion të Ministrisë së Financave për vlerësimin e ndikimeve ekonomike dhe buxhetore. Ka raste kur projektligjet vazhdojnë më tutje me procedurë të miratimit edhe pse nga opinionin që e ka Ministria e Financave, këto projektligje kanë kosto më të lartë buxhetore se sa janë vlerësimet për ndarje buxhetore.

Në këto raste, organizata sponzoruese merr përsipër që në mes kursimeve në programet ekzistuese, të mbulojë kosto të projektligjit dhe përmes rishikimit në kornizën afatmesme të shpenzimeve dhe proceseve të reja buxhetore të bëjë edhe rregullimet e tjera të nevojshme për implementimin e këtyre projektligjeve.

Në disa raste organizata sponzoruese merr obligimet që përmes amendamenteve në Kuvend të rregullojë ose të largojë pikat e projektligjit që mund të kenë kosto të pambuluar buxhetore.

Sikurse mund të kuptohet nga kjo që u paraqit më lartë, vlerësimi i ndikimit financiar paraqet një proces të ndërlikuar gjithëpërfshirës, i cili kërkon pjesëmarrje të gjerë institucionale, ku kapaciteti edhe statistika, informata, andaj është edhe kompleks, që duhet trajtuar me kujdes të veçantë. Ministria e Financave në çdo kohë është e përkushtuar për ta ndihmuar këtë proces dhe organi sponzorues, gjatë përgatitjes së legjislacionit dhe vlerësimit të ndikimit buxhetor, qoftë në fazën kur legjislacioni është në përgatitje dhe grupe punuese, apo në fazat tjera të shqyrtimit, duke kontribuar që tani të kemi legjislacion të zbatueshëm brenda mundësive buxhetore. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, ministër!
Deputet, ke pyetje shtesë?

SALIH MORINA: Faleminderit, ministër!
Unë e theksova që kemi ligje, për të cilat ministria juaj ka kërkuar që t'i kthehet Kuvendit. Është fjala për Ligjin për ndihmë juridike falas, për shkak të implikimeve të mëdha buxhetore. E di që ka edhe ligje të tilla, të cilat që nga viti 2008 janë në zyrat e juaja. Është fjala për Ligjin për sponzorizime, që nuk është sjellë në Parlament për shkak të implikimeve të mëdha buxhetore.

Prandaj, nëse me deklarata financiare, do të thotë, aprovohen ligje të tilla, që kanë implikime buxhetore, a mendoni që këto ligje të bëhen jashtë planifikimeve buxhetore për vite kalendarike dhe në kuadër të kornizës afatmesme, që është e miratuar nga ana e Qeverisë?

A do të ketë probleme për implementimin e këtyre ligjeve, sepse është një numër i konsiderueshëm. Unë e përmenda vetëm një ligj, por ekzistojnë mbi dhjetë ligje, do të thotë, që kanë ardhur në Parlament, kanë kaluar leximin e parë, kanë kaluar...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARI: Ministër, ke përgjigje?

MINISTRI BEDRI HAMZA: Faleminderit, zoti Morina!
Kërkesa e Ministrisë të Financave është që ligjet të aprovohen brenda deklaratës për vlerësimin e ndikimit buxhetor. Edhe gjatë procesit të aprovimit edhe gjatë amendamenteve në Kuvend, ne kërkojmë që këto ligje të mbesin brenda vlerësimit të ndikimit buxhetor. Në të kundërtën, për shkak të mundësive të limituara financiare, ne nuk kemi mundësi që buxhetin t'ua përshtatim ligjeve, prandaj ne duhet t'i përshtatim ligjet me buxhet, me qëllim që ligjet të jenë të implementueshme.

KRYETARI: Faleminderit, ministër!

Pyetje tjera nuk kemi. Pyetjet e deputetëve që nuk morën përgjigje në dy seancat plenare, do të publikohen në revistën e Kuvendit, neni 45, paragrafi 11 i Rregullores së Kuvendit.

Pika e radhës është:

3. Miratimi i procesverbaleve të mbledhjeve të mbajtura më 21 dhe 27 tetor 2011

Pyes, nëse keni vërejtje në këto procesverbale?

Atëherë, konstatoj se Kuvendi miratoi procesverbalet e mbledhjeve plenare të mbajtura më 21 dhe 27 tetor 2011.

Në rend dite kemi pikën e katërt:

4. Ratifikimi i Marrëveshjes për financim shtesë për fuqizimin e sektorit financiar dhe infrastrukturën e tregut në mes të Republikës së Kosovës dhe Shoqatës Ndërkombëtare për Zhvillim

Me kërkesë të Qeverisë së Kosovës, Komisioni për Buxhet dhe Financa i ka rekomanduar Kuvendit që të bëjë ratifikimin e Marrëveshjes për fuqizimin e sektorit financiar dhe infrastrukturën e tregut në mes të Republikës së Kosovës dhe Shoqatës Ndërkombëtare për Zhvillim.

Nga Qeveria e do dikush fjalën?

Fjalën e ka ministri i Financave, zoti Bedri Hamza, si propozues i çështjes.

BEDRI HAMZA: I nderuari kryetar i Kuvendit,
I nderuari zoti kryeministër,
Të nderuar zëvendëskryeministra, ministra,
Deputetë të nderuar,

Kam kënaqësinë që sot para jush të prezantoj Marrëveshjen financiare në mes të Republikës së Kosovës dhe Shoqatës Ndërkombëtare për Zhvillim për fuqizimin e sektorit financiar dhe infrastrukturën e tregut, të cilën Ministria e Financave me autoritetin e dhënë përmes Ligjit nr.03 L-175 për borxhin publik, pas negociatave të zhvilluara me Bankën Botërore, gjegjësisht Agjencinë Ndërkombëtare për Zhvillim ka nënshkruar marrëveshje për kredi në vlerë prej 4.300.000 SDR, që është afërsisht e barabartë me 4.932.000 euro. Nga shuma totale e kësaj kredie, 1.820.000 SDR janë nënshkruar si kredi për Bankën Qendrore dhe pjesa tjetër prej 2.480.000 SDR janë kredi në emër të Qeverisë së Republikës së Kosovës.

Kredia në përgjithësi është me kushte shumë të volitshme dhe për një projekt shumë të rëndësishëm, i cili do të fuqizojë sektorin financiar dhe infrastrukturën e tregut në Kosovë. Marrëveshja është nënshkruar me datën 3 gusht 2011, dhe ka këto kushte:

- kredia do të ketë një kamatë simbolike dhe do të aplikohet 0,75% në vit mbi bilancin e disburësuar dhe një taksë zotuese prej 0,5% në vit mbi bilancin e padisburësuar,
- kredia ka një greys periudhë prej dhjetë vitesh dhe një afat pagese, po ashtu prej dhjetë vitesh tjera, duke filluar me pagesën në vitin 2021, për të përfunduar kthimin në vitin 2031,
- koha e maturimit të kredisë është 20 vjet, greys periudha është 10 vjet,
- është paraparë që projekti të fillojë të implementohet në fund të vitit 2011, dhe zgjatë deri në qershor të vitit 2014.

Projekti është i rëndësisë së veçantë për faktin se mbulon një sferë të rëndësishme të institucioneve të tregut të Kosovës. Ne kemi për synim të ndërtojmë një bankë qendrore funksionale, ta pavarur, me standarde evropiane. Kjo do të rritë besimin në sektorin financiar dhe stabilitetin e përgjithshëm të sektorit. Stabiliteti financiar i vendit është jetik për një zhvillim të qëndrueshëm dhe afatgjatë.

Në këtë kuadër projekti ka për objektiv rritjen e stabilitetit dhe zhvillimin e sektorit financiar dhe sforcimin e infrastrukturës së tregut të këtij sektori. Përmes këtij projekti do të financohen disa sfera të fushëveprimit të Bankës Qendrore: përmirësimi afatgjatë institucional, kapacitetit financiar dhe qëndrueshmërisë, përmirësimi i rregullativës së Bankës Qendrore në sferën e mbikëqyrjen bankare të kompanive të sigurimeve dhe institucioneve tjera, që ka vlerën prej 80.000 SDR.

Themelimi i sistemit të pagesave të vazhdueshme, me qëllim të minimizimit të riskut gjatë balancimeve të pagesave, ngritjen e besimit tek bankat komerciale, që është në shumë prej 1.200.000 SDR.

Themelimi i sistemit rezervë për Bankën Qendrore për të mundësuar funksionim të vazhdueshëm në rast të fatkeqësive, që është në shumë prej 540.000 SDR dhe një komponentë, po ashtu e rëndësishme e këtij projekti, është edhe financimi me kapital themelor i Fondit për sigurimin e depozitave. Ky fond tanimë ka filluar të funksionojë dhe ne presim që përmes tij të shohim ngritjen e mëtejme të besimit dhe qëndrueshmërisë së sektorit bankar. Për tërheqjen e këtyre fondeve, së bashku me Bankën Qendrore jemi zotuar për përmbushjen e disa parakushteve të cilat kryesisht lidhen me funksionalizimin e fondit për sigurimin e depozitave, obligime të cilat pothuajse janë përmbushur tashmë.

Implementues i projektit do të jetë Banka Qendrore, në koordinim me Ministrinë e Financave dhe institucionet tjera. Me këtë rast, falënderoj personalin e Bankës Botërore për angazhimin e vazhdueshëm në përkrahjen e shtetit dhe institucioneve të Kosovës.

Ne jemi të përkushtuar, që këtë bashkëpunim ta vazhdojmë edhe në të ardhmen.

Përfundimisht, të nderuar deputetë, duke pasur parasysh rëndësinë e këtij projekti për Kosovën, si dhe kushtet e volitshme të kësaj kredie, ju ftoj që ta votoni këtë marrëveshje financiare.

- A mund të vazhdoj me të dytën, sepse janë dy marrëveshje?

KRYETARI: Vjen pika 5 e rendit të ditës, e vazhdojmë. Faleminderit!

Kërkoj që deputetët të kthehen në sallë, pasi që na duhet 2/3 e Kuvendit për të marrë vendim.

Fjalën e ka kryetarja e komisionit funksional, deputetja Safete Hadërgjonaj, për arsyetimin e raportit, me rekomandime!

SAFETE HADËRGJONAJ: Faleminderit, zoti kryetar!

I nderuari zoti kryeministër,
Të nderuar Kabinet qeveritar,
Kolegë deputete,

Komisioni për Buxhet e Financa, në mbledhjen e mbajtur më datën 1 nëntor të këtij viti, ku ka qenë i pranishëm edhe ministri i Financave për të dhënë sqarime plotësuese rreth kësaj marrëveshje, ka shqyrtuar Marrëveshjen për financim shtesë për fuqizimin e sektorit financiar dhe infrastrukturën e tregut në mes të Republikës së Kosovës dhe Shoqatës Ndërkombëtare për Zhvillim dhe ka rekomanduar ratifikimin e kësaj marrëveshjeje.

Komisioni për Buxhet dhe Financa ka pasur takim edhe me përfaqësuesit e Bankës Botërore, ende pa u nënshkruar kjo marrëveshje, ku është njoftuar për qëllimin e kësaj marrëveshjeje, që është rritja e stabilitetit dhe zhvillimit të sektorit financiar, si dhe avancimi i infrastrukturës së këtij tregu. Pra, fjala është për një marrëveshje për kredi dhe financim me vlerë 4.900.000 euro, sqarimet e të cilit i dha ministri dhe s'dua të futem në këtë çështje.

Marrëveshja në fjalë për tri komponentet e nënhuazuara të Bankës Qendrore të Kosovës, në vlerë prej 2.087.667 euro, reflektohet në buxhetin e Republikës së Kosovës vetëm si detyrim i mundshëm, detyrim i cili nuk do të ketë efekt në buxhetin e Republikës së Kosovës, në rast se Banka Qendrore kryen obligimet financiare në bazë të marrëveshjes nënhuazuese, të nënshkruar në mes të Ministrisë së Financave dhe Bankës Qendrore të Kosovës, kur të gjitha obligimet financiare dhe obligimet tjera mbi implementimin e projektit i bartë Banka Qendrore, përfshirë këtu edhe obligimet për kthimin e kredisë, pagesën e taksës së zotimit dhe taksës së shërbimit.

Komisioni për Buxhet njëzëri ka përkrahur këtë marrëveshje dhe i rekomandon Kuvendit që të bëjë ratifikimin e kësaj marrëveshjeje. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Radha është e kryetarëve të grupeve parlamentare. E doni fjalën?

Ju, nuk po doni fjalën! Mirë e keni, por ne duhet të kemi mbi 80 deputetë prezentë në sallë.

(Ndërhyrje)

Jo, ishin 83 deputetë, tash janë 71! Regjia, i bini ziles, që deputetët të kthehen në sallë!

Nëse jeni dakord, kalojmë në pikën e 5-të dhe pastaj votojmë, nëse e kemi prezencën e mjaftueshme.

Do të thotë, kalojmë në pikën e 5-të:

5. Ratifikimi i Marrëveshjes për financimin e Projektit për bujqësi dhe zhvillim rural në mes të Republikës së Kosovës dhe Shoqatës Ndërkombëtare për Zhvillim

Me kërkesë të Qeverisë së Kosovës, Komisioni për Buxhet dhe Financa i ka rekomanduar Kuvendit që të bëjë ratifikimin e Marrëveshjes për financimin e Projektit për bujqësi dhe zhvillim rural në mes të Republikës së Kosovës dhe Shoqatës Ndërkombëtare për Zhvillim.

Ftoj ministrin e Financave, zotin Bedri Hamza, si propozues i çështjes që ta marrë fjalën! Ministër, e ke fjalën!

BEDRI HAMZA: Faleminderit, zoti kryetar!

Më lejoni që të paraqes para jush sot marrëveshjen e dytë financiare, të cilën Ministria e Financave, me autoritetin e dhënë përmes Ligjit nr.03 L-175 për borxhet publike, pas negociatave të zhvilluara me Bankën Botërore, gjegjësisht Agjencionin Ndërkombëtar për Zhvillim, ka nënshkruar Marrëveshjen financiare, në formë të kredisë në vlerë prej rreth 14.682.496 euro për Projektin e bujqësisë dhe zhvillimit rural.

Marrëveshja është nënshkruar më datën 26 korrik 2011 dhe sot paraqitet për ratifikim.

Kushtet e marrëveshjes janë:

- kredia do të ketë një kamatë simbolike dhe do të aplikohet 0,75 në vit mbi bilancin e disburësuar me një taksë zotuese prej 0,5% në vit mbi bilancin e padisburësuar.
- Kredia ka një greys periudhë prej 10 vjetësh dhe një afat pagese po ashtu prej 10 vitesh, duke filluar me pagesë në vitin 2021, për të përfunduar kthimin në vitin 3031.
- Është paraparë që zbatimi i kësaj marrëveshjeje të fillojë në fund të vitit 2011 dhe të përfundojë më 31 korrik 2017.

Dëshiroj t'ju njoftoj se Ministria e Bujqësisë e ka negociuar këtë marrëveshje me Bankën Botërore në aspektin teknik për një kohë të gjatë dhe ajo reflekton nevojat e Ministrisë të Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural dhe të sektorit të bujqësisë për zhvillimin në përgjithësi. Sidoqoftë, qëllimi kryesor është që përmes kësaj kredie të ndihmohen fermerët, por edhe agropërpunimi në rritjen e prodhimtarisë dhe në rritjen e

konkurrueshmërisë në sektorin e blegtorisë dhe të hortikulturës, duke i zbatuar masat e zgjedhura të planit për bujqësi dhe zhvillim rural.

Ideja kryesore është që përmes kësaj kredie të implementohet bazuar në konceptin e programit të grandeve plotësuese, e cila konsiderohet që të jetë mjet i përshtatshëm për të përmirësuar zhvillimin e sektorit bujqësisë në Kosovë.

Është e rëndësishme që të thuhet se ky model i mbështetjes ndikon edhe në rritjen e investimeve nga sektori privat, duke pasur parasysh se projekti do të financohet deri në shkallë prej 50% edhe nga përfituesi.

Vlera e nënprojekteve që do të financohen përmes kësaj kredie do të jetë 30.000 euro deri në 200.000 euro për masën e parë dhe të dytë të planit për bujqësi dhe zhvillim rural, ose deri në 50% të vlerës së projektit.

Komponenti i parë – kemi të bëjmë me transferimin e njohurive në sektorin rural. Komponenti i parë do të shërbejë për forcimin e shërbimeve këshillimore për fermerët dhe ndërmarrjet komerciale e gjysmëkomerciale të agropërpunimit, në mënyrë që të jenë në gjendje që t'i planifikojnë investimet dhe të shfrytëzojnë ndihmën financiare, që u vihet në dispozicion nga komponenti i dytë i këtij projekti dhe nga skema të tjera të grandeve të donatorëve si: DANID-a, Komisioni Evropian, Programi i Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural dhe në të ardhmen edhe nga skemat e instrumentit të BE-së për ndihmën e paraaderimit në zhvillimin rural.

Komponenti i dytë – rritja e investimeve për të nxitur zhvillimin e qëndrueshëm agrorural. Ky komponent do të përkrahë implementimin e planit të bujqësisë për zhvillim rural 2007-2013, nëpërmjet financimit për ristrukturimin e potencialit fizik në sektorin agrorural, përmirësimin e përpunimit dhe marketingut të produkteve bujqësore. Do të bëhet financimi i projekteve për bujqësi dhe zhvillim rural me qëllim të rritjes ekonomike dhe nxitjes së konkurrencës në sektorin rural, nëpërmjet promovimit të teknologjive të reja për modernizimin e fermave dhe ndërmarrjeve bujqësore dhe agropërpunuese.

Komponenti i tretë – menaxhimi i projektit, koordinimi, monitorimi dhe vlerësimi. Sikur në të gjitha rastet e projekteve të tilla, edhe për menaxhimin e këtij projekti do të themelohet njësi e realizimit të projektit, e cila do të punojë me autoritetin menaxhues dhe me njësinë e pagesave, e cila është përgjegjëse për zbatimin e projektit.

Të gjitha rregullat dhe procedurat e implementimit të këtij projekti janë të bazuara në procedurat e programit IPAD dhe aktualisht Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural është duke i zbatuar edhe në implementimin e programit nga buxheti i Kosovës.

Përfundimisht, të nderuar deputetë, duke marrë parasysh rëndësinë e këtij projekti për Kosovën, si dhe kushtet e volitshme të kësaj kredie, ju ftoj që ta votoni këtë marrëveshje financiare. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, ministër!

Para se t'i jap fjalën kryetares së Komisionit, kërkoj nga kryetarët e grupeve, që t'i ftojnë deputetët të jenë në sallë. Përndryshe, ata që nuk do të jenë këtu në momentin kur ne do të votojmë pas përfundimit të kësaj, do t'i kenë sanksionet që i kanë me Rregulloren e Punës së Kuvendit.

Fjalën e ka deputetja, Safete Hadergjonaj, kryetare e komisionit funksional, për arsyetimin e raportit me rekomandime.

SAFETE HADERGJONAJ: Zoti kryetar,

Komisioni për Buxhet e Financa ka shqyrtuar Marrëveshjen për financimin e Projektet për bujqësi dhe zhvillim rural në mes të Republikës së Kosovës dhe Shoqatës Ndërkombëtare për Zhvillim dhe i ka rekomanduar Kuvendit që të bëjë ratifikimin e kësaj marrëveshjeje.

Objektiv i kësaj marrëveshjeje është rritja e konkurrencës së sektorit bujqësor, arritja e një prodhimtarie të sigurt me produkte cilësore, gjenerimi i mundësive të punësimit dhe ngritja e standardit jetësor.

Komisioni ka vlerësuar se Kosova ka nevojë për investime në sektorin e bujqësisë, sepse direkt ndikohet në rritjen e punësimit, zvogëlimin e importit të prodhimeve bujqësore, si dhe mundësohet rritja e eksporteve në tregjet rajonale dhe të Bashkësisë Evropiane. Pas marrjes së informatave më të detalizuara nga ministri i financave, që ishte i ftuar në mbledhje rreth vlerës së donacioneve dhe vlerës së kredisë dhe kushteve dhe mundësive të kthimit të kredisë, komisioni ka rekomanduar Kuvendit njëzëri që të bëjë ratifikimin e marrëveshjes. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!

Me kartela prezentë janë 93 deputetë. Gjendja e fundit që kemi identifikuar, është 71. Do të thotë, sipas prezencës fizike janë 83. Ju njoftoj që për të votuar për këto dy pika të rendit të ditës, nevojiten 80 vota të deputetëve “për”? Jo, do të votojmë me 84. A jeni që të deklarohe mi me ngritje dore? Mirë, faleminderit! Atëherë, votojmë për ratifikimin e marrëveshjes për financimin shtesë për fuqizimin e sektorit financiar dhe infrastrukturën e tregut në mes të Republikës së Kosovës dhe Shoqatës Ndërkombëtare për Zhvillim.

Kush është “për”, sekretaria e numëroni votat!

Ju faleminderit! A ka “kundër”, abstenim?

Me 84 vota “për”, Kuvendi ratifikoi Marrëveshjen për fuqizimin e sektorit financiar dhe infrastrukturën e tregut në mes të Republikës së Kosovës dhe Shoqatës Ndërkombëtare për Zhvillim.

Tani votojmë për ratifikimin e Marrëveshjes për financimin e projektit për bujqësi dhe zhvillim rural në mes të Republikës së Kosovës dhe Shoqatës Ndërkombëtare për Zhvillim. Përsëri votimi bëhet me ngritje dore.

Kush është “për”? Ju faleminderit!

A ka “Kundër”, abstenim?

Me 84 vota, Kuvendi ratifikoi Marrëveshjen për financimin e projektit për bujqësi dhe zhvillim rural në mes të Republikës së Kosovës dhe Shoqatës Ndërkombëtare për Zhvillim.

Ju faleminderit!

Kalojmë në pikën e gjashtë trendit të ditës.

6. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për sigurinë e përgjithshme të produkteve

Në bazë të nenit 56 të Rregullores së Kuvendit, Komisioni funksional ka shqyrtuar Projektligjin dhe Kuvendit ia ka paraqitur raportin me rekomandime, për shqyrtim në parim.

Ftojme ministren e Tregtisë dhe të Industrisë, zonjën Mimoza Kusari Lila, që në emër të Qeverisë të Republikës së Kosovës para deputetëve të Kuvendit ta prezantojë dhe arsyetojë projektligjin.

MINISTRJA MIMOZA KUSARI LILA: I nderuar kryetar i Kuvendit!

Të nderuar ministra,

Të nderuar deputetë,

Më lejoni që në emër të Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë, si bartëse e këtij projektit legjislativ, të përmend shkurtimisht arsyet për hartimin e Projektligjit për sigurinë e përgjithshme të produkteve, qëllimin dhe fushëveprimin e këtij Projektligji, rolin dhe rëndësinë që ka në vendosjen e sistemit të gjithmbarshëm ekonomik, për fushën e sigurisë së përgjithshme të produkteve në Republikën e Kosovës. Në funksion të përmbushjeve të obligimeve për të asociuar mekanizmat e Bashkimit Evropian, duke pretenduar për një qasje të mundshme në tregun unik të BE-së, industrisë kosovare i nevojitet infrastruktura e nevojshme për të filluar procesin e përafrimit me kërkesat themelore dhe ato të përgjithshme që shtrojnë direktivat e BE-së, e në veçanti direktivat për sigurinë e përgjithshme të produkteve 2001/95 EC, ku është baza e këtij projektligji.

Qëllimi i Projektligjit është që të sigurohet niveli i lartë i mbrojtjes së përdoruesve, përkatësisht konsumatorëve dhe të sigurohet qarkullim i mallrave të konsumit në tregun e brendshëm. Në bazë të dispozitave të këtij projektligji, prodhuesit obligohen që të plasojnë në treg vetëm produktet e sigurta, distributorët obligohen që të veprojnë me kujdesin e duhur dhe në pajtim me kërkesat e përcaktuara të sigurisë, sidomos në rastet e dorëzimit të produkteve për të cilat janë në dijeni ose është dashur të kenë dijeni se nuk i plotësojnë këto kërkesa.

Në rast se prodhuesit ose distributorët janë në dijeni se çfarë rreziku për konsumatorë paraqesin produktet të cilat i kanë plasuar në treg, janë të detyruar që për këtë të informojnë organet kompetente inspektuese që të zbatojnë mbikëqyrjen e tregut. Me qëllim të efikasitetit të zbatimit të këtij projektligji, janë specifikuar dhe kompetencat e

organeve kompetente inspektuese. Gjithashtu, ndëshkimet e ngritura janë ndëshkimet në rastin e kundërvajtjes.

Rëndësia e Projektligjit për sigurinë e përgjithshme të produkteve është se vendos objektivat kyç të cilët kanë të bëjnë me sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit të konsumatorëve. Kërkesat e përgjithshme të cilat dalin nga ky projektligj përcaktojnë qartë dhe saktë rezultatin e dëshiruar që duhet të arrihet në ngritjen e infrastrukturës së cilësisë dhe vendosjen në treg vetëm të produkteve të sigurta. Një rëndësi e veçantë është se projektligji jep të drejtën publikut për të qenë të informuar për produktet e rrezikshme dhe përmban dispozitat në bazë të të cilave organet kompetente do t'ju mundësojnë qytetarëve qasjen në informata që kanë të bëjnë me ekzistim e produkteve të rrezikshme në treg. Një nga obligimet ndaj Bashkësisë Evropiane është menaxhimi i sistemit për shkëmbimin e shpejtë të informatave për produktet të cilat paraqesin rreziqe serioze për konsumatorin.

Duke iu referuar dispozitave të Projektligjit për sigurinë e përgjithshme, do të nxirret Rregullorja për sistemin e shkëmbimit të informatave dhe njoftimin për produktet të cilat paraqesin rrezik për shëndetin dhe sigurinë e konsumatorëve. Raporti për produktet e rrezikshme, pasi të pranohet nga organet shtetërore kompetente për mbikëqyrjen e tregut, përgatitet dhe publikohet një herë në javë. Njoftimi përfshinë edhe fotografitë e produkteve të rrezikshme, specifikon në detaje rreziqet e mundshme, emrin e produktit të tregtuar dhe vendin e origjinës.

Projektligji përmban 21 nene, ku përfshihet qëllimi, fusha e zbatimit, përkufizimet, kërkesat e përgjithshme për sigurinë e produkteve, detyrimet e prodhuesve, detyrimet e distributorëve, informimi i publikut, nxitja e masave vullnetare, sistemi i shkëmbimit të shpejtë të informacioneve, mbikëqyrja inspektuese, mbikëqyrja doganore, dispozitat ndëshkuese, dispozitat kalimtare, dispozitat shfuqizuese dhe hyrje në fuqi, të cilat janë pjesë përmbyllëse të këtij projektligji.

Duke u bazuar në rëndësinë që paraqet ky projektligj për Republikën e Kosovës, si dhe legjislacionin e saj për ngritjen e infrastrukturës të cilësisë, lëvizjen e lirë të mallrave, vendosjen në treg dhe përdorimin e tyre pa e rrezikuar jetën dhe shëndetin e përdoruesve, përkatësisht konsumatorëve, rekomandoj që Projektligji për sigurinë e përgjithshme të produkteve pas shqyrtimit të miratohet dhe të dërgohet në procedim të mëtutjeshëm. Ju faleminderit!

KRYETARI: Ju faleminderit, ministre!

Në emër të komisionit funksional, kryetari i Komisionit për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri, deputeti Zenun Pajaziti.

ZENUN PAJAZITI: Ju faleminderit, zoti kryetar!

Të nderuar anëtarë të Kabinetit,

Deputetë,

Komisionit për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri, në bazë të nenit 56, paragrafi 2 të Rregullores së Kuvendit, në mbledhjen e mbajtur të datës 1.11, e ka

shqyrtuar në parim Projektligjin për sigurinë e përgjithshme të produkteve dhe ka vendosur që Kuvendit t'i rekomandojë miratimin në parim të këtij projektligji, pra të Projektligjit për sigurinë e përgjithshme të produkteve dhe i ftojme deputetë dhe grupet që ta mbështesin. Ju faleminderit!

KRYETARI: Ju faleminderit!

Në emër të Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike, deputeti Lutfi Zharku e ka fjalën.

LUTFI ZHARKU: I nderuar kryetar!

I nderuar zëvendëskryeministër, ministra,

Grupi Parlamentar i LDK-së e ka shqyrtuar Projektligjin për sigurinë e përgjithshme të produkteve dhe përkundër asaj se do ta votojë në parim, shpreh rezerva substanciale sa i përket arsyshmerisë dhe vet përmbajtjes së tij.

Projektligji i propozuar nuk ofron ndonjë avancim domethënës në këtë fushë, duke marrë parasysh se pothuaj se i tërë ligji aktual, që është në fuqi nga viti 2005, është përfshirë në Projektligjin e propozuar, vetëm se është përmirësuar gjuha, gjegjësisht janë përmirësuar disa vërejtje, disa shprehje të cilat me siguri kanë qenë pasojë i një përkthimi të dobët edhe në atë kohë.

Nga memorandumit shpjegues thuhet qartë se arsye kryesore për hartimin e këtij projektligji është përfshirja e emetimit të rrezikshëm, si kategori e cila do t'i ndihmonte inspektoratit një mbikëqyrje më të mirë të tregut. Duke marrë parasysh se ligji aktual, sikurse çdo ligj tjetër në fuqi, parasheh mundësinë që për zbatimin e tij Ministria të nxjerr akte tjera nënligjore, kjo çështje ka mundur të rregullohet në këtë mënyrë, pa pasur nevojë të humbet energji dhe kohë në hartimin e projektligjit të ri. Një akt nënligjor i kësaj natyre është edhe Udhëzimi administrativ 2009/06, për sigurinë e lodrave, kurse në anën tjetër, në kuadër të Inspektoratit të tregut ekziston sektori për siguri të produkteve, i themeluar që në vitin 2009. Natyrisht që janë të pa pranueshme arsyet për hartimin e këtij projektligji, si ajo që të bëjmë harmonizimin e ligjit aktual me vendet e rajonit.

Në përgjithësi, Projektligji më shumë merret me në sferën e inspektimit, gjegjësisht mbikëqyrjes së tregut, që është lëmi tanimë e rregulluar me ligjet në fuqi, se sa që rregullon obligimet dhe detyrimet e prodhuesve, gjegjësisht distributorëve mbi sigurinë e produkteve. Vërejtjet në përmbajtjen e Projektligjit kanë të bëjnë me dispozitat që rregullojnë informimin e publikut, mbikëqyrjen inspektuese dhe doganore, si dhe dispozitat ndëshkuese.

Tek informimi i publikut mbi produktet e rrezikshme parashihet që informacione të caktuara mbi karakteristikat e produkteve nuk do të jenë në dispozicion, nëse konsiderohen sekret i punës. Kjo le të hapur mundësinë që karakteristikat e caktuara të rrezikshme të produkteve, që prodhuesi apo distributori nuk do t'i bëjë publike për shkak të konkurrencës, të mbulojë me petkun e sekretit të punës në rastet kur ato janë të panjohura për konsumatorin. Kjo mëdyshje bëhet edhe më e madhe pasi që nuk është

definuar çka nënkupton sekreti i punë, gjegjësisht a kemi të bëjmë me sekretin afarist të prodhuesit apo me sekretin e operimit të produktit.

Siç e ceka më lart, projektligji në mënyrë të panevojshme dhe shpeshherë në dëm të efikasitetit, detajizon shumë aktivitete pothuaj se të përditshme të organit kompetent inspektues, e të cilat në shumicën e rasteve janë në mënyrë të njëjtë të sanksionuara me ligjet në fuqi. Siç dihet, kompetencat e Inspektoratit të Tregut janë të përcaktuara qartë me Ligjin mbi Inspektoratin dhe mbikëqyrjen e tregut, i cili me nenin 9, paragrafi 1.2 përcakton qartë si kompetencë sigurinë e produkteve në treg. Në anën tjetër, shumica e kompetencave të parapara në këtë dispozitë të projektligjit të propozuar janë të definuar me nenin 11 të ligjit të cekur më lartë, i cili rregullon mbikëqyrjen inspektuese.

Është obligim i Ministrisë që detajizimin e mëtutjeshëm të këtij neni ta bëjë me udhëzim administrativ e jo me ligj të ri. Po ashtu, neni 11.10 mbi shpenzimet e procedurës së verifikimit dhe inspektimit të produktit, është i panevojshëm, sepse edhe kjo çështje është e rregulluar me dispozitat e Ligjit mbi Inspektoratin dhe mbikëqyrjen e tregut. E njëjta vlen edhe për ankesën sipas nenit 11.7 dhe 11.8, të cilat janë të rregulluara me dispozita të nenit 27 të Ligjit në fuqi mbi Inspektoratin.

Po ashtu, shprehim rezervë sa i përket dispozitave të nenit 14, të cilat kanë të bëjnë me mbikëqyrje doganore, ku përfshihet e drejta e doganave që të ndalojmë produktet nëse dyshojnë se karakteristikat e caktuara të tyre mund të paraqesin rrezik serioz për sigurinë. Ne vlerësojmë se kjo kompetencë është në kundërshtim me kompetencën primare të doganave, që është vlerësimi, caktimi dhe mbledhja e detyrimeve doganore dhe taksave në importe dhe eksporte. Kam përshtypje se përfshirja e institucioneve shtesë në mbikëqyrjen e kësaj fushe, më shumë do të krijojë paqartësi në kompetenca dhe zbatim të ligjit, duke lënë mundësinë e hapur për fajësime tjera, për fajësime të njëra – tjetrës, sa që do të ndihmojnë në shtimin e efikasitetit të mbikëqyrjes së kësaj fushe.

Në fund, shpresoj se këto vërejtje nuk do të përdoren nga ana e ministres si shkas për largim, suspendim, ulje në pozitë, dhënie të vërejtjeve apo ndërmarrjen e masave tjera disiplinore ndaj shërbyesve civilë të cilët janë punësuar në Ministri gjatë kohës sa unë e kam udhëhequr atë, nga parimi bazë se politikat mbi të cilat mbështeten ligjet hartohen nga ana e Kabinetit të ministrit, e jo nga shërbyesit civilë. Ju faleminderit!

KRYETARI: Ju faleminderit!

Në emër të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike, deputeti Berat Buzhala e ka fjalën.

BERAT BUZHALA: Ju faleminderit, zoti kryetar!

Të nderuar kolegë deputetë,

Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës e ka shqyrtuar këtë projektligj, e përkrah atë në parim, kërkon edhe prej grupeve tjera që ta përkrahin. Për rëndësinë dhe peshën e këtij ligji, foli edhe ministria Mimoza Kusari Lila.

Është për t'u theksuar se çështja e emetimit të rrezikshëm është njëra prej pikave kryesore në këtë projektligj, që do t'i lehtësojë punën e mbikëqyrjes së tregut, përkatësisht Inspektoratit për sigurinë e përgjithshme të produkteve, e cila në ligjin ekzistues nuk është rregulluar në nivelin e kërkesave të tregut, prandaj ne këtë e përkrahim dhe kërkojmë edhe prej grupeve tjera që ta votojnë. Ju faleminderit!

KRYETARI: Në emër të Grupit Parlamentar “Vetëvendosje”, deputeti Visar Ymeri e ka fjalën.

VISAR YMERI: Ju faleminderit, kryetar!

Edhe Lëvizja “Vetëvendosje” e përkrah në parim këtë ligj dhe natyrisht që vërejtjet tona që i kemi, e të cilat nuk po i përmendi të gjitha këtu, do t'i parashtrijmë përmes Komisionit funksional për ta bërë këtë ligj më të mirë.

Një çështje e cila u ngrit këtu, pra, edhe nga parafolësit, e që është shumë e rëndësishme, është që ka në disa raste, veçanërisht te informimi i publikut ky ligj më shumë i jep rëndësi sekretit të punës, se sa sigurisë të njerëzve dhe sigurisë së produktit. Pra, ne si Kuvend jemi të obliguar që kur t'i miratojmë ligjet, ta kemi parasysh interesin e qytetarit më shumë se sa interesat që mund të jenë nganjëherë edhe partikulare të biznesit. Prandaj, në këtë drejtim duhet të jemi të kujdesshëm që ligjet që kalojnë, të jenë vërtet, t'i shërbejnë sigurisë së qytetarit në raport me konsumin e produkteve, edhe atëherë kur ato mund të shihen si shkelje e sekretit të punës. Ju faleminderit!

KRYETARI: Ju faleminderit!

Në emër të Grupit Punues të Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës, deputeti Xhevdet Neziraj e ka fjalën.

XHEVDET NEZIRAJ: Ju faleminderit, i nderuar zoti kryetar!

Zëvendëskryeministër, ministre,

Edhe Grupi i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës e ka shqyrtuar dhe e ka analizuar seriozisht këtë projektligj dhe në fillim po them se do ta përkrahim, mirëpo shumica e neneve është e rregulluar edhe me Ligjin që është mbi Inspektoratin, prandaj ka përsëritje shumë në këtë projektligj dhe unë kisha shpresuar që Qeveria në të ardhmen të bien ligje më të mira, ligje që gjejnë zbatim dhe mos ta përsërisin njëri - tjetrin. Nëse dëshirojnë që vetëm të rritet numri i ligjeve, atëherë le të bien për çdo ditë ligje që e përsërisin njëri - tjetrin.

Mirëpo, ne në parim do ta përkrahim dhe i kemi disa vërejtje, si në nenin 14 dhe nenet tjera, por kontributi ynë do të jepet në komisionin funksional dhe në komisionet kryesore, ku do të kalojë projektligji. Ju faleminderit!

KRYETARI: Ju faleminderit!

Në emër të Grupit Parlamentar Koalicioni për Kosovë të Re, kryetarja e Grupit, deputetja Myzejene Selmani e ka fjalën.

MYZEJENE SELMANI: Ju faleminderit, kryetar!

Përshëndetje për ministrat dhe të gjithë deputetët që janë prezentë në seancë sot!

Koalicioni për Kosovë të Re e ka shqyrtuar Projektligjin për sigurinë e përgjithshme të produkteve. Jemi në dijeni se ka qenë dhe është në fuqi Ligji për sigurinë e përgjithshme nga viti 2005, mirëpo duke marrë parasysh që ligjet duhet të ndryshojnë edhe në bazë të direktivave të BE-së, me të cilat duhet të harmonizohen ligjet e Kosovës për një arsye shumë të rëndësishme që Kosova të shkojë drejt Bashkimit Evropian, atëherë mund të thuhet se Projektligji ka pësuar disa ndryshime nga ligji i mëparshëm dhe fatbardhësisht që këto ndryshime duhet të shkojnë në të mirë të konsumatorëve dhe njëkohësisht në të mirë të vet njerëzve të cilët do të jenë në zbatim të këtij ligji.

Ligji në përgjithësi është një ligj i cili tregon çështjen nëpërmes të neneve të saj, harmonizimin e neneve të cilat duhet të jenë në të mirë të qytetarëve për sigurinë e përgjithshme të produkteve, janë të harmonizuara me direktivat e Bashkimit Evropian, mirëpo ka mundësi që në këto nene, gjatë amendamentimit të ketë disa ndryshime për arsye se na e kemi edhe Ligjin e Inspektoratit, qysh o fol nga parafolësit, mirëpo prapë se prapë edhe dënimet të cilat i bën Ministria në këtë rast, në lidhje me njerëz të cilët janë në tregun e brendshëm, është kompetencë e Ministrisë së Tregtisë dhe jep mundësinë që të ruhet konsumatori.

Esenca e gjithë Projektligjit është që gjatë këtij amendamentimit të Projektligjit në komisionet parlamentare, pikësynim të jetë konsumatori apo qytetari i Kosovës. Në parim, Koalicioni për Kosovë të Re e përkrah projektligjin dhe të gjitha mundësitë tjera që të nxjerrim një ligj më të mirë në leximin e dytë, do të jepen në komisionin parlamentar. Ju faleminderit!

KRYETARI: Ju faleminderit! Në emër të Grupit Parlamentar të SLS-së, deputetja Biserka Kostiq e ka fjalën.

BISERKA KOSTIĆ: Zahvaljujem, gospodine predjedavajući!
Parlamentarna grupa Samostalne liberalne stranke je takođe razmotrila Nacrt zakona o opštoj sigurnosti proizvoda, podržaće zakon u načelu, a svoj doprinos daće u komisiji. Hvala!

KRYETARI: Ju faleminderit!

Në emër të Grupit Parlamentar “6+”, nuk ka të lajmëruar.

Numër për të votuar nuk kemi. Pas 15 minutash pauzë, shpresoj se do të bëhet kuorumi për votim.

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARI: Të nderuar deputetë,

Në sallë janë 36 deputetë. Seanca vazhdon të hënën, në orën 10:00.

E hënë, më 14.11.2011, ora 10:00, vazhdimi i seancës
Drejton seancën: Kryetari i Kuvendit të Kosovës, zoti Jakup Krasniqi

KRYETARI: Të nderuar deputetë,
I nderuar zëvendëskryeministër, ministër,
Vazhdojmë me punimet e Seancës së Kuvendit të Republikës së Kosovës, të filluar më 11 nëntor 2011, për pikat e mbetura.

Konstatohet se në sallë janë 72 deputetë, që do të thotë mund t'ia fillojmë punën.

Vazhdojmë me pikën e 6-të të rendit të ditës:

6. Votimi në parim i Projektligjit për sigurinë e përgjithshme të produkteve

Lus deputetët që t'i vendosin kartelat e tyre edhe regjinë që të përgatitet për votim dhe votojmë tash!

Me 68 vota “për”, asnjë “kundër” dhe dy abstenime, Kuvendi miratoi në parim Projektligjin për sigurinë e përgjithshme të produkteve.

Kërkohej nga komisioni funksional dhe komisionet e përhershme që në afatin e paraparë me Rregulloren e Kuvendit ta shqyrtojnë projektligjin dhe Kuvendit t'ia paraqesin raportet me rekomandime.

Vazhdojmë me pikën e 7-të të rendit të ditës:

7. Shqyrtimi i Projektligjit për hekurudhat e Kosovës

Komisionet parlamentare kanë shqyrtuar Projektligjin për Hekurudhat e Kosovës dhe Kuvendit i kanë rekomanduar miratimin e tij me amendamentet e propozuara.

Kryetari i komisionit funksional, nuk e do fjalën, apo e do? Fjalën e ka deputeti Zenun Pajaziti!

ZENUN PAJAZITI: Faleminderit, zoti kryetar!

Komisioni për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri e ka trajtuar gjatë këtij projektligji. Është rasti, me qenë se ky projektligj ka qenë në agjendën e ligjeve, të cilat kanë qenë edhe si pikë sfidë në Raportin e Progresit, i falënderojmë të gjithë partnerët, të gjithë ata që kanë kontribuar. Edhe institucionin e ekzekutivit, pra, Qeverinë, që bashkërisht kemi arritur edhe pse është një numër më i madh i amendamenteve, kemi arritur që sot ta sjellim në Kuvend, për aprovim.

Prandaj, i lus të gjithë deputetët dhe grupet parlamentare që ta votojnë këtë projektligj. Faleminderit!

KRYETARI: Një sqarim! Në këtë projektligj janë propozuar gjithsej 65 amendamente. Komisioni FunkSIONAL për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri, ka propozuar 62 amendamente.

Amendamenti nr. 31 dhe amendamenti nr. 47 janë propozuar nga Komisioni për Buxhet dhe Financa dhe kanë përkrahjen e komisionit funksional. Ndërsa, amendamenti nr. 42 i propozuar, po ashtu, nga Komisioni për Buxhet dhe Financa, nuk është përkrahur nga komisioni funksional. Prandaj, vazhdojmë me votimin e amendamenteve!

Amendamenti nr. 1.

A ka kundër? Nuk ka!

A ka abstenim? Nuk ka!

Miratohet.

Amendamenti nr. 2.

A ka kundër?

A ka abstenim?

Miratohet.

Amendamenti 3.

A ka kundër?

A ka abstenim?

Miratohet.

Amendamenti 4.

Ka kundër? Nuk ka!

Abstenim? Nuk ka!

Miratohet

Amendamenti 5.

Kundër? S'ka!

Abstenim? S'ka!

Miratohet.

Amendamenti 6.

Kundër? S'ka!

Abstenim? S'ka!

Miratohet.

Amendamenti 7.

Kundër? S'ka!

Abstenim? S'ka!

Miratohet.

Amendamenti 8.
Kundër? S'ka!
Abstenim? S'ka!
Miratohet.

Amendamenti 9.
Kundër? S'ka!
Abstenim? S'ka!
Miratohet.

Amendamenti 10.
Kundër? S'ka!
Abstenim? S'ka!
Miratohet.

Amendamenti 11.
Kundër? S'ka!
Abstenim? S'ka!
Miratohet.

Amendamenti 12.
Kundër? S'ka!
Abstenim? S'ka!
Miratohet.

Amendamenti 13.
Kundër? S'ka!
Abstenim? S'ka!
Miratohet.

Amendamenti 14.
Kundër? S'ka!
Abstenim? S'ka!
Miratohet.

Amendamenti 15.
Kundër? S'ka!
Abstenim? S'ka!
Miratohet.

Amendamenti 16.
Kundër? S'ka!
Abstenim? S'ka!
Miratohet.

Amendamenti 17.
Kundër? S'ka!
Abstenim? S'ka!
Miratohet.

Amendamenti 18.
Kundër? S'ka!
Abstenim? S'ka!
Miratohet.

Amendamenti 19.
Kundër? S'ka!
Abstenim? S'ka!
Miratohet.

Amendamenti 20.
Kundër? S'ka!
Abstenim? S'ka!
Miratohet.

Amendamenti 21.
Kundër? S'ka!
Abstenim? S'ka!
Miratohet.

Amendamenti 22.
Kundër? S'ka!
Abstenim? S'ka!
Miratohet.

Amendamenti 23.
Kundër? S'ka!
Abstenim? S'ka!
Miratohet.

Amendamenti 24.
Kundër? S'ka!
Abstenim? S'ka!
Miratohet.

Amendamenti 25.
Kundër? S'ka!
Abstenim? S'ka!
Miratohet.

Amendamenti 26.

Kundër? S'ka!

Abstenim? S'ka!

Miratohet.

Amendamenti 27.

Kundër? S'ka!

Abstenim? S'ka!

Miratohet.

Amendamenti 28.

Kundër? S'ka!

Abstenim? S'ka!

Miratohet.

Amendamenti 29.

Kundër? S'ka!

Abstenim? S'ka!

Miratohet.

Amendamenti 30.

Kundër? S'ka!

Abstenim? Nuk ka!

Miratohet.

Amendamenti 31.

Kundër? S'ka!

As abstenim, s'ka!

Miratohet!

Pra, ishte amendament i përkrahur nga dy komisionet.

Amendamenti 32.

Kundër? S'ka!

Abstenim? S'ka!

Miratohet.

Amendamenti 33.

Kundër? S'ka!

Abstenim? S'ka!

Miratohet.

Amendamenti 34.

Kundër? S'ka!

Abstenim? S'ka!

Miratohet.

Amendamenti 35.
Kundër? S'ka!
Abstenim? S'ka!
Miratohet.

Amendamenti 36.
Kundër? S'ka!
Abstenim? S'ka!
Miratohet.

Amendamenti 37.
Kundër? S'ka!
Abstenim? S'ka!
Miratohet.

Amendamenti 38.
Kundër? S'ka!
Abstenim? S'ka!
Miratohet.

Amendamenti 39.
Kundër? S'ka!
Abstenim? S'ka!
Miratohet.

Amendamenti 40.
Kundër? S'ka!
Abstenim? S'ka!
Miratohet.

Amendamenti 41.
Kundër? S'ka!
Abstenim? S'ka!
Miratohet.

Amendamenti 42,
I propozuar nga Komisioni për Buxhet dhe Financa, pa përkrahjen e komisionit funksional. Le të deklarohe kryetarët e komisioneve. Një herë i komisionit propozues. Safete Hadërgjonaj, s'është këtu. Nënkyetari i komisionit. Nuk ka. Atëherë, shkon varianti i parë. Do të thotë, Nuk votohet amendamenti 42.

Amendamenti 43.
Kundër? S'ka!
Abstenim? S'ka!
Miratohet.

Amendamenti 44.
Kundër? S'ka!
Abstenim? S'ka!
Miratohet.

Amendamenti 45.
Kundër? S'ka!
Abstenim? S'ka!
Miratohet.

Amendamenti 46.
Kundër? S'ka!
Abstenim? S'ka!
Miratohet.

Amendamenti 47. Është ky amendament i mbështetur nga dy komisionet.
Kundër? S'ka!
Abstenim? S'ka!
Miratohet.

Amendamenti 48.
Kundër? S'ka!
Abstenim? S'ka!
Miratohet.

Amendamenti 49.
Kundër? S'ka!
Abstenim? S'ka!
Miratohet.

Amendamenti 50.
Kundër? S'ka!
Abstenim? S'ka!
Miratohet.

Amendamenti 51.
Kundër? S'ka!
Abstenim? S'ka!
Miratohet.

Amendamenti 52.
Kundër? S'ka!
Abstenim? S'ka!
Miratohet.

Amendamenti 53.

Kundër? S'ka!

Abstenim? S'ka!

Miratohet.

Amendamenti 54.

Kundër? S'ka!

Abstenim? S'ka!

Miratohet.

Amendamenti 55.

Kundër? S'ka!

Abstenim? S'ka!

Miratohet.

Amendamenti 56.

Kundër? S'ka!

Abstenim? S'ka!

Miratohet.

Amendamenti 57.

Kundër? S'ka!

Abstenim? S'ka!

Miratohet.

Amendamenti 58.

Po mungon këtu 58, mos është ndonjë gabim këtu! Do të thotë, 59 duhet të jetë 58.

Kundër? S'ka!

Abstenim? S'ka!

Miratohet.

Amendamenti 59.

Kundër? S'ka!

Abstenim? S'ka!

Miratohet.

Amendamenti 60.

Kundër? S'ka!

Abstenim? S'ka!

Miratohet.

Amendamenti 61.

Kundër? S'ka!

Abstenim? S'ka!

Miratohet.

Amendamenti 62.
Kundër? S'ka!
Abstenim? S'ka!
Miratohet.

Amendamenti 63.
Kundër? S'ka!
Abstenim? S'ka!
Miratohet.

Dhe amendamenti 64.
Kundër? S'ka!
Abstenim? S'ka!
Miratohet.

Në sallë kemi prezentë 80 deputetë. Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votimin e ligjit në tërësi. Votojmë tash.
Konstatohet se me 76 vota “për”, asnjë “kundër”, një abstenim, Kuvendi miratoi Ligjin për hekurudhat e Kosovës.

Drejtimin e seancës e merr nënkryetari i Kuvendit, zoti Xhavit Haliti

KRYESUESI: Vazhdojmë me pikën e 8-të të rendit të ditës.
Unë mendoj se është mirë që deputetët të cilët nuk kanë kartela, ta bëjnë praktikë që në mëngjes të paraqiten me një copë letër që s'ka kartelë x deputeti dhe të mos ketë nevojë pastaj për të reaguuar, sepse po e shoh që disa s'kanë kartela dhe kryetari me siguri s'i ka vërejtur. Megjithatë, shumica ka qenë absolute në Kuvend dhe s'ka ndonjë problem.
Vazhdojmë me pikën e 8-të të rendit të ditës, që është:

8. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për tregti me jashtë

Komisionet parlamentare e kanë shqyrtuar Projektligjin për tregti me jashtë dhe Kuvendit i kanë rekomanduar miratimin e tij me amendamentet e propozuara. Ftoj kryetarin e Komisionit funksional për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri, deputetin Zenun Pajazitin, që para deputetëve të arsyetojë raportimin me rekomandime. Zoti Pajaziti, e keni fjalën!

ZENUN PAJAZITI: Faleminderit, zoti kryesues!
Të nderuar anëtarë të Kabinetit, deputetë,
Komisioni për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri e ka trajtuar edhe këtë projektligj, e ka sjellë në aktin final, në aprovim në Kuvend. Është rasti që t'i falënderoj të gjithë anëtarët e komisionit, meqenëse është një prej projektligjeve që ka pasur një numër të madh të amendamenteve dhe ka pasur debat në komision, edhe ide për kthimin e projektligjit. Meqenëse është një prej projektligjeve të nevojshme dhe ka qenë i kërkuar një kohë të gjatë, falënderoj për gatishmërinë e komisionit që ta trajtojmë. Dhe, po ashtu, komisionet tjera të cilat kanë bërë vërejtje, Komisioni i Legjislacionit dhe

Komisioni për Integritet Evropian, të cilat ne i kemi adoptuar vërejtjet në variantin e fundit ose në amendamentet rrjedhëse. Kështu që unë, duke i falënderuar, i ftoj edhe grupet parlamentare dhe deputetët që ta aprovojnë këtë projektligj. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit!

Siç e dini, në bazë të nenit 53, paragrafit 1 të Rregullores së Kuvendit, të drejtë për diskutime kanë përfaqësuesit e komisioneve të përhershme, përfaqësuesit e grupeve parlamentare, përfaqësuesi i Qeverisë dhe deputetët. Nuk është paraqitur askush.

Në këtë projektligj janë propozuar gjithsej 42 amendamente nga komisioni funksional. Vazhdojmë me votimin e amendamenteve të propozuara, sipas radhës së paraqitur në raportin e komisionit funksional.

Konstatohet që në sallë janë 80 deputetë. Fillojmë me votimin e amendamenteve.

Amendamenti 1.

Kundër? S'ka!

Abstenim? S'ka!

Miratohet.

Amendamenti 2.

Kundër? S'ka!

Abstenim? S'ka!

Miratohet.

Amendamenti 3.

Kundër? S'ka!

Abstenim? S'ka!

Miratohet.

Amendamenti 4.

Kundër? S'ka!

Abstenim? S'ka!

Miratohet.

Amendamenti 5.

Kundër? S'ka!

Abstenim? S'ka!

Miratohet.

Amendamenti 6.

Kundër? S'ka!

Abstenim? S'ka!

Miratohet.

Amendamenti 7.

Kundër? S'ka!

Abstenim? S'ka!

Miratohet.

Amendamenti 8.
Kundër? S'ka!
Abstenim? S'ka!
Miratohet.

Amendamenti 9.
Kundër? S'ka!
Abstenim? S'ka!
Miratohet.

Amendamenti 10.
Kundër? S'ka!
Abstenim? S'ka!
Miratohet.

Amendamenti 11.
Kundër? S'ka!
Abstenim? S'ka!
Miratohet.

Amendamenti 12.
Kundër? S'ka!
Abstenim? S'ka!
Miratohet.

Amendamenti 13.
Kundër? S'ka!
Abstenim? S'ka!
Miratohet.

Amendamenti 14.
Kundër? S'ka!
Abstenim? S'ka!
Miratohet.

Amendamenti 15.
Kundër? S'ka!
Abstenim? S'ka!
Miratohet.

Amendamenti 16.
Kundër? S'ka!
Abstenim? S'ka!
Miratohet.

Amendamenti 17.
Kundër? S'ka!
Abstenim? S'ka!
Miratohet.

Amendamenti 18.
Kundër? S'ka!
Abstenim? S'ka!
Miratohet.

Amendamenti 19.
Kundër? S'ka!
Abstenim? S'ka!
Miratohet.

Amendamenti 20.
Kundër? S'ka!
Abstenim? S'ka!
Miratohet.

Amendamenti 21.
Kundër? S'ka!
Abstenim? S'ka!
Miratohet.

Amendamenti 22.
Kundër? S'ka!
Abstenim? S'ka!
Miratohet.

Amendamenti 23.
Kundër? S'ka!
Abstenim? S'ka!
Miratohet.

Amendamenti 24.
Kundër? S'ka!
Abstenim? S'ka!
Miratohet.

Amendamenti 25.
Kundër? S'ka!
Abstenim? S'ka!
Miratohet.

Amendamenti 26.
Kundër? S'ka!
Abstenim? S'ka!
Miratohet.

Amendamenti 27.
Kundër? S'ka!
Abstenim? S'ka!
Miratohet.

Amendamenti 28.
Kundër? S'ka!
Abstenim? S'ka!
Miratohet.

Amendamenti 29.
Kundër? S'ka!
Abstenim? S'ka!
Miratohet.

Amendamenti 30.
Kundër? S'ka!
Abstenim? S'ka!
Miratohet.

Amendamenti 31.
Kundër? S'ka!
Abstenim? S'ka!
Miratohet.

Amendamenti 32.
Kundër? S'ka!
Abstenim? S'ka!
Miratohet.

Amendamenti 33.
Kundër? S'ka!
Abstenim? S'ka!
Miratohet.

Amendamenti 34.
Kundër? S'ka!
Abstenim? S'ka!
Miratohet.

Amendamenti 35.
Kundër? S'ka!
Abstenim? S'ka!
Miratohet.

Amendamenti 36.
Kundër? S'ka!
Abstenim? S'ka!
Miratohet.

Amendamenti 37.
Kundër? S'ka!
Abstenim? S'ka!
Miratohet.

Amendamenti 38.
Kundër? S'ka!
Abstenim? S'ka!
Miratohet.

Amendamenti 39.
Kundër? S'ka!
Abstenim? S'ka!
Miratohet.

Amendamenti 40.
Kundër? S'ka!
Abstenim? S'ka!
Miratohet!

Amendamenti 41.
Kundër? S'ka!
Abstenim? S'ka!
Miratohet!

Amendamenti 42.
Kundër? S'ka!
Abstenim? S'ka!
Miratohet!

Votojmë tekstin e projektligjit në tërësi me amendamentet e miratuara. Lus regjinë dhe deputetët që të përgatiten për votim. Në sallë janë 73 deputetë. Votojmë tani!
Pa kartelë, tre deputetë.
Faleminderit! Konstatoj se me 62 vota me elektronikë, 2 pa elektronikë “për”, Kuvendi miratoi projektligjin në tërësi, me amendamentet e miratuara.

Dy janë pa kartelë, do të thotë 64 vota janë “për”, asnjë “kundër”, asnjë abstenim. Pra, Kuvendi miratoi Projektligjin për tregti me jashtë.

Pika e 9-të e rendit të ditës:

9. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për marrëveshje ndërkombëtare

Komisionet parlamentare kanë shqyrtuar Projektligjin për marrëveshje ndërkombëtare dhe Kuvendit i kanë rekomanduar miratimin e tij me amendamentet e propozuara. Ftoj kryetarin e Komisionit funksional për Punë të Jashtme, Albin Kurti, ose përfaqësuesin e komisionit, që para deputetëve ta arsyetojë raportin me rekomandime. Albini nuk është këtu. Përfaqësuesi i komisionit, zoti Hyseni e ka fjalën!

HYDAJET HYSENI: Faleminderit, zoti kryesues!

Zonja dhe zotërinj deputetë,

Të nderuar zëvendëskryeministra, ministra,

Më lejoni që në mungesë të kryetarit të komisionit të paraqes për shqyrtim dhe miratim amendamentet në Projektligjin për marrëveshje ndërkombëtare, të cilat i janë bashkëngjitur raportit të komisionit dhe u janë shpërndarë me kohë deputetëve. Komisioni ka shqyrtuar projektligjin brenda afateve të parapara, ka formuar grupin punues, ka siguruar ekspertizën relevante profesionale, ka marrë në konsideratë dhe ka inkorporuar vërejtjet dhe sugjerimet e dala nga diskutimi në parim i këtij projektligji dhe, si rezultat, ka hartuar amendamentet e propozuara. Janë gjithsej 16 amendamente, të gjitha të komisionit dhe të miratuara me konsensus edhe në grupin punues, edhe në komision.

Amendamentet e propozuara i përmirësojnë, i rregullojnë dhe i saktësojnë dispozitat e këtij ligji dhe e lehtësojnë zbatimin në praktikë të tij. Por, për hir të së vërtetës dhe në interes të procesit të mëtejshëm ligjvënës, na duhet të theksojmë faktin se projektligji i propozuar me gjithë përmirësimet e bëra, nuk mëton dhe nuk mund të mëtonte rregullimin e tërësishëm dhe përfundimtar ligjor të gjithë materies që lidhet me marrëveshje ndërkombëtare, sidomos me rregullativën e ratifikimit të tyre. Konfuzionin dhe ndërlikueshmërinë në këtë fushë për pasojat dhe anomalitë evidente, prodhohen dhe determinohen edhe nga gjuha konfuze, e paqartë dhe dykuptimore e dispozitave përkatëse kushtetuese.

Duke qenë dispozita kushtetuese, ato edhe nuk mund të përmirësoheshin me dispozita ligjore. Në kushte të këtilla, komisioni dhe grupi punues u gjetëm në një situatë udhëkryqi, midis rrezikut të rilegjitimimit të këtyre dispozitave difektioze, do të thosha dhe, nga ana tjetër, rrezikut të përplasjes me dispozitat kushtetuese. Si kompromis, komisioni vendosi të shqyrtojë ligjin e propozuar, të bëjë ato ndryshime e përmirësime, që u konsideruan të drejta, për momentin, dhe të realizueshme, duke lënë mundësinë që përmirësimet e mëtejshme të rregullohen me ndryshimet kushtetuese.

Mbetet që dilemat dhe paqartësitë e konstatuara të rregullohen me ndryshimet vijuese kushtetuese ose me ato që pasohen. Ftojme deputetët që të miratojnë amendamentet e propozuara, e përsëris, të miratuara me konsensus në Komisionin për Punë të Jashtme. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit!

Nuk ka të tjerë të paraqitur për diskutim.

Në këtë projektligj janë propozuar gjithsej 16 amendamente nga komisioni funksional. Vazhdojmë me votimin e amendamenteve të propozuara, sipas radhës së paraqitur në raportin funksional. Në sallë janë 73 deputetë.

Amendamenti 1.

Kundër? S'ka!

Abstenim? S'ka!

Miratohet.

Amendamenti 2.

Kundër? S'ka!

Abstenim? S'ka!

Miratohet.

Amendamenti 3.

Kundër? S'ka!

Abstenim? S'ka!

Miratohet.

Amendamenti 4.

Kundër? S'ka!

Abstenim? S'ka!

Miratohet.

Amendamenti 5.

Kundër? S'ka!

Abstenim? S'ka!

Miratohet.

Amendamenti 6.

Kundër? S'ka!

Abstenim? S'ka!

Miratohet.

Amendamenti 7.

Kundër? S'ka!

Abstenim? S'ka!

Miratohet.

Amendamenti 8.
Kundër? S'ka!
Abstenim? S'ka!
Miratohet.

Amendamenti 9.
Kundër? S'ka!
Abstenim? S'ka!
Miratohet.

Amendamenti 10.
Kundër? S'ka!
Abstenim? S'ka!
Miratohet.

Amendamenti 11.
Kundër? S'ka!
Abstenim? S'ka!
Miratohet.

Amendamenti 12.
Kundër? S'ka!
Abstenim? S'ka!
Miratohet.

Amendamenti 13.
Kundër? S'ka!
Abstenim? S'ka!
Miratohet.

Amendamenti 14.
Kundër? S'ka!
Abstenim? S'ka!
Miratohet.

Amendamenti 15.
Kundër? S'ka!
Abstenim? S'ka!
Miratohet.

Amendamenti 16.
Kundër? S'ka!
Abstenim? S'ka!
Miratohet.

Të nderuar kolegë, vazhdojmë me votimin e tekstit të projektligjit në tërësi, me amendamentet e miratuara. Në sallë janë 68 deputetë. Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim. Votojmë tani!

Konstatohet se me 55 vota me kartelë, 2 pa kartelë “për”, asnjë “kundër” dhe asnjë abstenim, Kuvendi miratoi Ligjin për marrëveshjet ndërkombëtare.

Pika e dhjetë e rendit të ditës:

10. Shqyrtimi i Raportit të Komisionit për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, Persona të Pagjetur dhe Peticione për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për mbrojtjen nga dhuna në familje

Komisioni për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, Persona të Pagjetur dhe Peticione, ka bërë mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për mbrojtjen nga dhuna në familje dhe Kuvendit ia ka paraqitur raportet me rekomandime.

Kryetarja e Komisionit për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, Persona të Pagjetur dhe Peticione, deputetja Suzan Novobërdaliu, do ta arsyetojë raportin me rekomandime. Nuk është këtu.

Deputetja Rita Hajzeraj- Beqaj, do ta zëvendësojë.

RITA HAJZERAJ- BEQAJ: Faleminderit, zoti kryesues!

Në emër të Komisionit, pra Komisioni për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, Persona të Pagjetur dhe Peticione, në mbledhjen e mbajtur më 13. 4. 2011, ka caktuar Grupin punues për monitorimin e zbatimit të Ligjit për mbrojtjen nga dhuna në familje. Komisioni ka ndërmarrë këtë aktivitet në funksion të përmbushjes së mandatit të cilin e jep Rregullorja e punës së Kuvendit dhe me motivin kryesor që të sigurohet realizimi i qëllimeve të ligjvënësve dhe zbatimi i ligjeve.

Gjendja jo e kënaqshme e viktimave nga dhuna në familje e që është prezente edhe pas hyrjes në fuqi të këtij ligji, e ka shtyrë Komisionin që ta monitorojë këtë projektligj.

Unë dua t'i njoftoj deputetët se ne kemi bërë disa ndryshime apo rekomandime që është fshirë rekomandimi numër 4 dhe 5 dhe janë shtuar katër rekomandime tjera.

Pra, rekomandimi i parë është që Ministria e Shëndetësisë obligohet që të vë në dispozicion me qëllim të këtij ligji dhe udhëzimi administrativ gjithë kapacitetin e vet, përfshirë këtu aspektin profesional, infrastrukturën ekzistuese dhe sipas nevojës të bashkëpunojë me të gjitha ministritë dhe institucionet tjera relevante.

Rekomandimi i dytë, është me qëllim të krijimit dhe implementimit sa më të mirë të programit të Kosovës, për dhunë në familje, pra, Qeveria e Republikës së Kosovës, do ta ketë obligim të vetin krijimin e buxhetit shtetëror për këtë qëllim.

Rekomandimi tjetër ka të bëjë me atë se ministrinë gjegjëse, pra të cekura në Ligjin për mbrojtjen nga dhuna në familje dhe në bazë të udhëzimit administrativ, do të jenë kompetente për alokim të një pjese të këtij buxheti në financimin e aktiviteteve specifike. Këto ministri do të jenë të obliguara që një pjesë specifike të buxhetit të ndarë nga Qeveria të përkrahin OJQ-ët të cilat merren me këtë natyrë të punës si dhe strehimoret ekzistuese.

Rekomandimi i katërt ka të bëjë me atë se Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale, në bashkëpunim me Ministrinë e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, duhet të hartojë program të veçantë për riintegrim, shkollimin dhe aftësimin profesional dhe punësimin e personave të prekur nga dhuna në familje.

Tani dua të flas në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së. Ne si Grup Parlamentar i LDK-së e përkrahim raportin në tërësi, ndërsa sa i përket raportit, unë ju lus, zoti kryesues, që t'ia jepni fjalën kryetares së Grupit punues, Albana Gashit, nga „Vetëvendosja“. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Të drejtën për fjalë e kanë të gjithë deputetët, pa përjashtim. Nga Qeveria nuk ka dikush që e ka kërkuar fjalën. Kryetarët ose përfaqësuesit e grupeve parlamentare, në emër të PDK-së është deputeti Kurtan Kajtazi.

KURTAN KAJTAZI: Faleminderit, kryesues!

I nderuar ministër,

Të nderuar deputetë,

Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës e ka analizuar raportin e Komisionit për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, Persona të Pagjetur dhe Peticione lidhur me monitorimin e zbatimit të Ligjit për mbrojtjen nga dhuna në familjen numër 2010/36, me qëllim të sigurimit të zbatimit sa më të efektshëm të Ligjit për mbrojtjen nga dhuna në familje.

Komisioni ka vepruar në bazë të nenit 28 të Ligjit për mbrojtjen nga dhuna në familje, në të cilin thuhet se Qeveria e Kosovës, 6 muaj pas hyrjes në fuqi të këtij ligji, nxjerr aktet nënligjore që burojnë nga ky ligj.

Qëllimi i monitorimit është që të shqyrtohet Ligji për mbrojtjen nga dhuna në familje në krijimin e mekanizmave adekuat për mbrojtjen, mbështetjen dhe rehabilitimin e viktimave.

Në raport janë sintetizuar të gjitha informacionet relevante të mbledhura gjatë në periudhe disamujore nga ana e Grupit punues.

Në bazë të fakteve relevante të Grupit punues, vizitave në institucione publike, të dëgjimeve publike dhe pas shqyrtimit të dokumentacionit relevant, Komisioni i ka nxjerrë disa rekomandime të bëra në këtë raport. Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës e mbështet dhe i rekomandon Kuvendit për miratim raportin, bashkë me rekomandimet e nxjerra më vonë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit!

Grupi Parlamentar i LDK-së foli.

Atëherë, Grupi Parlamentar i „Vetëvendosjes“, Albana Gashi.

ALBANA GASHI: Faleminderit, kryesues!

Në bazë të Rregullores së Kuvendit të Republikës së Kosovës dhe në pajtim të nenit 73 të kësaj rregulloreje, Komisioni për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, Persoana të Pagjetur dhe Peticione, ka bërë mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për mbrojtjen nga dhuna në familje.

Ky ligj ka për qëllim parandalimin e dhunës në familje në të gjitha format e saj, me masat e përshtatshme ligjore të pjesëtarëve të familjes që janë viktimat të dhunës në familje, duke u kushtuar vëmendje të veçantë të moshuarve dhe personave me aftësi të kufizuara.

Ky ligj po ashtu ka për qëllim edhe trajtimin e kryerësve të dhunës në familje dhe lehtësimin e pasojave.

Bazuar në mandatin e autorizuar nga Komisioni, kam zhvilluar aktivitetet e nevojshme me qëllim të mbledhjes së informacioneve dhe të dhënave mbi nivelin e zbatimit të këtij ligji.

Gjatë procesit mbikëqyrës kam realizuar disa aktivitete, siç janë takimet zyrtare me institucionet dhe vizita në terren, organizimin e dëgjimit publik si dhe raportimin e mbledhjeve të Komisionit për aktivitetet e zhvilluara.

Gjatë takimeve me institucionet si dhe gjatë vizitave në terren, janë identifikuar shumë probleme që kanë të bëjnë me zbatimin e këtij ligji, siç janë: mosnxjerrja e akteve nënligjore nga ana e Qeverisë, ashtu siç është paraparë për një afat prej 6 muajsh, pas hyrjes në fuqi të Ligjit për mbrojtjen nga dhuna në familje; zvarritja e aprovimit të programit të Kosovës kundër dhunës në familje; mungesa e vullnetit për adresimin e qartë të dhunës në familje si fenomen negativ në shoqëri dhe mungesa e akteve nënligjore e që kanë rezultuar në një varg ngecjesh siç vijon.

Ministria e Shëndetësisë nuk e ka ndarë buxhetin për trajnimin e kryerësve të dhunës në familje, si dhe personave të varur nga alkooli dhe substancat psiko-trope; mungesa e punëtorëve socialë gjatë orarit të natës dhe mungesa e tyre gjatë seancave; mungesa e linjës së posaçme telefonike në stacionet policore për raportim të dhunës në familje; mungesa e dhomave të intervistimit në disa stacione policore; dështimi i gjykatave komunale në rastin e lëshimit të urdhrave për mbrojtje dhe urdhrave për mbrojtje emergjente; zvarritja e lëndëve nëpër gjykata, si dhe mungesa e gjykatësve dhe e prokurorëve. Kushtetuta dhe ligjet e Republikës së Kosovës nuk zbatohen në pjesën veriore të Kosovës, në këtë kontekst as Ligji për mbrojtjen nga dhuna në familje. Nuk ka Qendër për Punë Sociale dhe viktimat e dhunës në familje detyrohen t'u drejtohen strukturave paralele, çështja e mosdefinimit të kompetencës lidhur me bartjen e viktimave në mes policisë dhe mbrojtësve të viktimave.

Dhe duke marrë për bazë problemet e identifikuara, arrijmë në përfundim se ky ligj deri më tash është pjesërisht i zbatueshëm dhe ka shumë mangësi në funksionimin e mirëfilltë të tij, për shkak të moskoordinimit të institucioneve përgjegjëse, për çka duhet të merren masa konkrete për ndryshimin e gjendjes.

Prandaj, me qëllim të ndryshimit dhe përmirësimit të gjendjes aktuale, me qëllim të rritjes së nivelit të zbatimit të këtij ligji, Komisioni i propozon këto rekomandime:

1. Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale duhet t'i caktojë prioritetet dhe afatet kohore për përpilimin dhe zbatimin e akteve nënligjore e që janë në harmoni me këtë ligj.
2. Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale, në bashkëpunim me Ministrinë e Shëndetësisë, Ministrinë e Drejtësisë, Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal, Ministrinë e Punëve të Brendshme, Ministrinë e Kulturës, Rinisë dhe Sportit dhe Ministrinë e Arsimit është përgjegjëse për mbështetjen dhe ngritjen e strukturave ndihmëse dhe infrastrukturës së nevojshme që shërben për mbështetjen dhe plotësimin e nevojave për persona ndaj të cilëve është ushtruar dhunë në familje dhe të fillojnë me hartimin e udhëzimit administrativ me qëllim të krijimit të fondit me kod të veçantë financiar, ashtu siç parashihet në Ligjin për menaxhimin e financave publike.
3. Ministria e Punëve të Brendshme duhet të mbështesë ngritjen e kapaciteteve të sigurisë, të strukturave mbështetëse që ofrojnë strehim dhe shërbime për persona që kanë përjetuar dhunë në familje.
4. Qeveria e Kosovës duhet të emërojë koordinatorin apo koordinatoren nacionale për mbrojtje nga dhuna në familje në nivel të një ministrie, ashtu siç është koordinatori nacional kundër trafikimit me qenie njerëzore, me qëllim të organizimit të përcjelljes, të zhvillimit dhe të koordinimit sa më efikas të veprimeve të përbashkëta ndërministrorë, ekipi i përbashkët ndërministror duhet t'i përgatisë profesionalisht ekipet e ekspertëve nga fusha e mbrojtjes sociale dhe të fëmijëve, shëndetësore, të drejtësisë, të mbrojtjes së të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, në bashkëpunim me përfaqësuesit e shoqërisë civile dhe me ata të institucioneve arsimore.

Rekomandimi tjetër, ekipi ndërministror mund t'u sugjerojë Qeverisë së Kosovës dhe institucioneve të tjera relevante, krijimin e shërbimeve ndihmëse ose shfrytëzimin dhe financimin e drejtpërdrejt të atyre ekzistuese për dobi të viktimave të dhunës në familje dhe atë strehimore për viktimat e dhunës në familje në çdo 50.000 banorë, përfshirë këtu akomodim të mirë dhe të sigurt, konsulentë profesional të kualifikuar si dhe në gjetjen e akomodimit afatgjatë për viktimat e dhunës në familje, qendër konsultuese dhe përkrahëse për viktimat e dhunës në familje për çdo 100.000 banorë e cila do të ofronte ndihmë proaktive, përfshirë ndihmë dhe konsulentë juridike.

Këto pra janë disa nga rekomandimet që komisioni ynë ka dhënë për këtë raport. Rekomandimet tjera i keni në raportet tuaja. Dhe në fund ftoj deputetët që nëse kanë ndonjë rekomandim që ka të bëjë me këtë raport, t'i paraqesin gjatë diskutimit nëse do ketë, në mënyrë që të merren parasysh nëse më vonë do të bëhet plotësimi dhe ndryshimi i këtij ligji. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit!

Në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, deputetja Kymete Bajraktari.

KYMETE BAJRAKTARI: Faleminderit, zoti kryesues!

Edhe Grupi Parlamentar i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës e ka analizuar këtë raport mbi monitorimin e Ligjit mbi dhunën në familje dhe njëherësh e përkrah raportin dhe rekomandimet e Komisionit. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit!

Në emër të Grupit Parlamentar Koalicioni Kosova e Re, Myzejene Selmani.

MYZEJENE SELMANI: Faleminderit, zoti nënkryetar!

Përshëndetje për të gjithë deputetët!

Koalicioni për Kosovë të Re e ka shqyrtuar raportin e Komisionit për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, Persona të Pagjetur dhe Peticione për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për mbrojtjen nga dhuna në familje. Dhe duke marrë parasysh se Komisioni në punën e tij e ka bërë një punë shumë të mirë dhe rekomandimet të cilat janë nxjerrë në bazë të këtij raporti, Koalicioni për Kosovën e Re e përkrah Raportin e Komisionit Parlamentar dhe njëkohësisht inkurajon Qeverinë që të zbatojë edhe më shumë Ligjin për mbrojtjen nga dhuna në familje. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit!

Grupi Parlamentar SLS, Biserka Kostiq!

BISERKA KOSTIĆ: Zahvaljujem, gospodine predsjedavajući!

I Parlamentarna grupa Samostalne liberalne stranke je razmotrila Izveštaj Komisije za ljudska prava o sprovođenju Nacrta zakona o zaštiti od nasilja u porodici i podržao njegovo glasanje sa preporukama. Hvala!

KRYESUESI: Faleminderit! Në emër të Grupit Parlamentar “6+”, deputetja Balje!

DUDA BALJE: Zahvaljujem!

I Parlamentarna grupa “6+” je izvršila razmatranje Izveštaja Komisije za ljudska prava o sprovođenju Zakona o zaštiti od nasilja u porodici i glasaće za njega.

KRYESUESI: Faleminderit!

Radha është e deputetëve.

Deputetja Teuta Sahatqija e ka fjalën.

TEUTA SAHATQIJA: Faleminderit, kryesues!

Së pari, desha të përgëzoj Komisionin për një punë jashtëzakonisht të mirë, për një punë në të cilën numerikisht kanë analizuar me raporte dhe i përgëzoj edhe për rekomandime, të cilat janë me të vërtetë rekomandime që duhet të trajtohen.

Edhe Grupi i grave deputete e ka mbajtur një tryezë, më datën 19, ku kanë qenë të ftuar, përveç presidentes, zëvendëskryeministrit Kuçi, Ombudspersonit, kanë qenë të ftuar edhe pjesëmarrës nga Policia, nga Ministria e Punës dhe Mirëqenies, nga shoqëria civile dhe shumë të tjera. Edhe aty dolën rekomandimet shumë të ngjashme.

Por, në anën tjetër, përveç përgëzimit për punën dhe për rekomandimet, është për keqardhje, është shumë për keqardhje që kjo temë kaq e rëndë, kjo temë e cila po e rëndon shoqërinë kosovare, të trajtohet numerikisht, thua ti se po i lexojmë numrat e telefonit apo diçka.

Dhuna në familje po ndodhë në Kosovë dhe nuk është vetëm ligji ai i cili e mbron. Dhuna në familje duhet të parandalohet edhe me mentalitet, edhe ne si pjesëmarrës të popullit tonë, të cilët jemi të zgjedhur, duhet të ngritemi dhe të flasim për këtë çështje. Unë sot pres prej burrave që janë këtu të përzgjedhurit, që t'u flasin atyre burrave tjerë që i vrasin gratë, që i dhunojnë gratë, që i lëndojnë gratë, që të çohen dhe të kërkojnë që ajo të parandalohet. Nuk parandalohet vetëm me rekomandime, nuk parandalohet me numra, nuk parandalohet me telefon, ju lutem, kjo është një çështje e dhimbshme.

Familja e cila është qelizë e shoqërisë, familja e cila rrit vlerat e një shoqërie, familja e cila i rrit fëmijët të cilët në qoftë se rriten në një ambient të duhur, janë fëmijë të mirë, janë prindër të mirë, janë anëtarë të mirë të një shoqërie.

Ne po i kalojmë këto thua ti po flasim nuk e di për çka, nuk po mund ta gjej për çka mund të flitet kështu qetë, pa emocion, pa ndonjë kërkesë për një dhunë në familje? Secili prej nesh njohim njerëz, njohim njerëz të cilët i lëndojnë gratë e tyre, njohim njerëz ku ndodhë dhuna në familje, te fëmijët. Secili prej nesh i dimë plotë fëmijë që janë nëpër strehimore, që nënën e kanë të vrarë, që babën e kanë në burg, që sot presin prej kësaj shoqërie. Nuk mjafton vetëm të flasim për numra, ju lutem!

Pres prej këtij Kuvendi, pres prej burrave, që të çohen e të kërkojnë ndalimin e dhunës në familje.

KRYESUESI: Faleminderit!
Radhën e ka deputetja Musliu.

GANIMETE MUSLIU: Faleminderit, zoti kryesues!

I nderuar ministër,

Të nderuara kolege dhe ju kolegë deputetë,

Edhe mua më lejoni që gjithashtu të përgëzoj Komisionin për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, Persona të Pagjetur dhe Peticione, të cilët na e kanë paraqitur Raportin mbi monitorimin e zbatimit të Ligjit për mbrojtjen nga dhuna në familje, ku kanë identifikuar vonesat në përpilimin dhe zbatimin e akteve ligjore dhe nënligjore dhe në bazë të fakteve

të nxjerra nga monitorimi i ligjit, kanë dhënë rekomandime që janë shumë të arsyeshme dhe të nevojshme.

Fatkeqësisht, dhuna në familje në Kosovë ende po vazhdon të trajtohet si një problem privat, që u përket vetëm familjeve të cilat po ballafaqohen me këto probleme. Kjo vjen si pasojë që shoqëria jonë ende është duke vepruar në bazë të normave morale dhe shumica e rasteve që po ndodhin mbesin ende të mbyllura nga vetë familja, por edhe nga rrethi shoqëror.

Përjetimet e luftës, tranzicioni, gjendja e rëndë ekonomike, tendencat e përshpejtuara drejt modernizimit, niveli i ulët i arsimimit, pabarazia gjinore, janë disa nga faktorët kryesor që çojnë deri tek dhuna në familje. Prandaj, ne duhet të punojmë të gjithë së bashku që ky problem të trajtohet me shumë kujdes dhe të mos neglizhohet nga organet kompetente, sepse kemi raste kur rastet e paraqitura të dhunës në familje janë neglizhuar apo thënë më mirë janë injoruar nga institucionet e vendit dhe po këto raste kanë përfunduar tragjikisht dhe kjo bën që edhe më tutje rastet e dhunës në familje të mbesin të izoluar.

Organizatat joqeveritare dhe shoqëria civile, megjithëse janë përballuar me shumë sfida e vështirësi, kanë bërë një punë të shkëlqyeshme për nxjerrjen në pah të këtij problemi dhe kanë sensibilizuar opinionin, përkatësisht kategoritë e prekura nga kjo dukuri negative për të drejtat e tyre dhe për mundësinë e parandalimit të dhunës në familje. Dhuna në familje e çdo forme qoftë, duhet të ndëshkohet dhe sanksionohet nga mekanizmat ligjor të çdo niveli. Prandaj, unë shfrytëzoj rastin që t'i ftoj të gjithë ata që janë të prekur nga dhuna në familje, mos të hezitojnë por t'i raportojnë rastet, sepse vetëm duke i raportuar rastet e tilla mund të trajtohen.

Edhe një herë e përgëzoj Komisionin parlamentar për nxjerrjen e këtij raporti dhe rekomandimet që i kanë ofruar Kuvendit, sot. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit!
Radhën e ka deputetja Krasniqi.

HASIME KRASNIQI: Faleminderit, zoti kryesues!
I nderuar ministër,
Të nderuar kolegë deputetë,
Po marr shkas të flas pak për dhunën në familje, bazuar në Raportin e Komisionit parlamentar që e ka bërë monitorimin e Ligjit për dhunën në familje.

Studimet në lidhje me dhunën në familje janë të pakta dhe të zbehta në Kosovë. Ashtu siç u tha paraprakisht, ky problem ende vazhdon të trajtohet si problem familjar, sepse zakonisht zhvillohet dhunë brenda mureve të shtëpisë dhe nuk trajtohet si problem i gjithë shoqërisë.

Barazia gjinore është e drejtë themelore qytetare, një vlerë e përbashkët e vendeve të Bashkimit Evropian e për këtë arsye një kusht i domosdoshëm për integrim.

Pra, si rezultat i traditave patriarkale shoqëria jonë ka qenë e dominuar nga meshkujt historikisht, grave u është diktuar prej kohësh që ta pranojnë rolin e të nënshtruarave, andaj dhuna në familje është më tepër e theksuar ndaj gruas, përkatësisht burrit ndaj gruas.

Si shoqëri, zakonisht themi se familja është e shenjtë, duke vlerësuar në masë të madhe, por mungon përkujdesja më e madhe institucionale. Dhuna ndaj grave, ndonëse është shkelja më e përhapur e drejtave të njeriut në botë, vazhdon të jetë më pak e vlerësuar. Dhuna është një problem i thellë shëndetësor, por ka pasojë plagosjen dhe vdekjen, cenon mirëqenien e grave dhe shkatërron dinjitetin dhe vetëvlerësimin.

Ky problem është shumë kompleks dhe shumë dimensional. Kur ka dhunë në shoqëri, nuk ka përparim në sferën e barazisë gjinore, mirëqenies dhe zhvillimit të qëndrueshëm. Ky fenomen nuk ndikon vetëm te gratë, por te të gjithë anëtarët e familjes e sidomos tek fëmijët.

Në familjet ku ka dhunë, fëmijët janë të ndikuar nga jetesat në një mjedis të tillë, mjedis frike, dhune, kërcënimi, krijon te fëmijët probleme emocionale, të natyrës së sjelljes dhe janë më pak të guximshëm për t'u përballur me sfidat e jetës.

A thua, Policia e Kosovës i ushtron përgjegjësitë e saj ndaj rasteve të raportuara në Policinë e Kosovës? Institucionet e drejtësisë sa janë në gjendje që t'i vënë para ligjit personat që ushtrojnë dhunë në familje, Prokuroria a i merr seriozisht rastet e tilla?

Edhe pse sipas disa të dhënave nga Policia e Kosovës, për rastet e raportuara të dhunës në familje ka një rënie të vogël nga viti në vit, por ende mbetet problem shumë shqetësues, andaj i mbështes të gjitha rekomandimet e Komisionit parlamentar, në mënyrë që kjo dukuri, ky fenomen, të reduktohet sa më shumë, sepse çrrënjësja e tij fare është e pamundur. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Nuk ka tjerë të paraqitur, me gjithë thirrjen që edhe burrat të diskutojnë, nuk është paraqitur asnjëri. Ka dhunë edhe ndaj burrave, besoj.

Atëherë, po vazhdojmë me votimin e Raportit të Komisionit për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, Persona të Pagjetur dhe Peticione lidhur me zbatimin e Ligjit për mbrojtjen nga dhuna në familje.

Konstatoj se në sallë janë 67 deputetë. Lus regjinë dhe deputetët që të përgatiten për votim dhe votojmë tani.

Konstatoj se me 63 vota me kartelë, 2 pa kartelë që bëjnë 65 “për”, asnjë “kundër” dhe asnjë “abstenim”, Kuvendi miratoi Raportin e Komisionit për të Drejtat e Njeriut, Barazi gjinore, Persona të pagjetur dhe Peticione lidhur me zbatimin e Ligjit për mbrojtjen nga dhuna në familje.

Vazhdojmë me pikën e njëmbëdhjetë të rendit të ditës:

11. Shqyrtimi i Raportit vjetor të auditimit nga Zyra e Auditorit të Përgjithshëm, për vitin 2010

Komisioni funksional për mbikëqyrjen e financave publike e ka shqyrtuar Raportin vjetor të auditimit nga Zyra e Auditorit të Përgjithshëm për vitin 2010 dhe Kuvendit ia ka rekomanduar për miratim.

Kryetari i Komisionit funksional, deputeti Ali Sadriu, ftohet që ta marrë fjalën për arsyetimin e raportit me rekomandime.

ALI SADRIU: Faleminderit, zoti nënkryetar!

Përshëndetje për ju, për ministrin!

Të nderuar deputetë,

Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike e ka shqyrtuar Raportin e auditimit të përgjithshëm për periudhën e vitit 2010, të hartuar nga ZAP-i dhe këtë e ka pasur në dy takime, ishte prezent edhe ministri i Financave, drejtori i Thesarit, kryetari i KRPP-së, drejtori i Njesisë Harmonizuese. Bashkërisht e shqyrtuam Raportin dhe erdhëm deri te këto konstatime.

Ky raport është i hartuar sipas standardeve të raportimit financiar dhe si i tillë shpalos në mënyrë të kënaqshme gjendjen e financave publike në Kosovë dhe menaxhimin e financave publike. Si të tillë, ne rekomandojmë miratimin e këtij raporti.

Megjithatë, nga pasqyrat e prezantuara ne kemi vërejtur disa lëshime dhe përmes këtyre rekomandimeve pretendojmë që të thërrasim angazhimin dhe eficiencën e Qeverisë, të reflektojnë në tejkalimin e këtyre problemeve.

1. Edhe pse një kohë të gjatë vërehet se organizatat buxhetore ende kanë çalime në mënyrën e hartimit të pasqyrave financiare dhe prezantimit të tyre, megjithatë brengë më e madhe është mënyra e regjistrimit të pasurisë, që nuk pason sipas udhëzimeve administrative dhe nuk është në pozitë të kënaqshme, prandaj një joprofesionalizëm dhe një jo punë e tillë, dëmton pronën e organizatave buxhetore.

2. Alarmante mbetet edhe gjendja rreth përmbushjes së rekomandimeve të cilat i ka paraqitur një vit më parë Zyra e Auditorit të Përgjithshëm për organizatën buxhetore.

Reflektimi në tejkalimin e këtyre të gjeturave është shumë në shkallë të ulët. Shembull, raporti i fundit, ishin 9 rekomandime, vetëm një e ka përmbushur, të tjerat thotë janë në proces, do të thotë është një shkallë shumë e ulët dhe kërkojmë që Qeveria kohë pas kohe të reflektojë në përmbushjen e atyre rekomandimeve.

3. Përderisa në disa raste auditorët e brendshëm të organizatës buxhetore e kanë kryer punën e tyre me profesionalizëm dhe kanë sinjalizuar menaxhmentin për dukuritë në të cilat kërkohet reflektim, ka raste kur menaxhmenti i injoron ato të gjetura dhe e sheh

auditorin e brendshëm si një lloj kontrole jo e këndshme dhe nuk i përfillë ato rekomandime. Mandej, ndodhë që Zyra e Auditorit të Përgjithshëm i gjen po të njëjtat rekomandime dhe i konstaton në raport. Këto i kemi edhe këtë vit.

4. Shkelja e procedurave të prokurimit vazhdon t'i shkaktojë humbje të mëdha buxhetit të konsoliduar të Kosovës, duke lënë hapësirë për keqpërdorime të shumta. Shkelen afatet e kryerjes së punës, shkelen standardet apo mbikëqyrja e standardeve dhe mu në këto baza ndodhë që është përfituar oferta për tenderim, por rezultatet flasin se punët e kryera nuk janë as për afër standardeve. Për atë, Kosova detyrohet brenda vitit të riparojë rrugë, përsëri kanalizime të reja, ujësjellës e tjerë. Kjo është pasojë e jo përcjelljes së punës sipas standardeve të hartuara.

5. Ne kemi vërejtur gjatë shqyrtimeve të raporteve se në organizata publike, Ligji për organizatat e kompanive publike i lë mundësinë që organizata publike vetë të përcaktojnë procedura dhe përzgjedhë kompaninë e cila do të auditojë raportin vjetor të tyre. Kjo lë për të kuptuar mundësinë e keqpërdorimeve, gjegjësisht mundësinë e mosprezantimit të gjendjes faktike që ndodhë në organizata, dhe

6. Është një problematikë, avanset e pambyllura, këto i kemi në shumë organizata dhe për këtë i kërkojmë Ministrisë të Financave, përkundër ligjit që në vija atë trasha e figuron mënyrën dhe procedurën dhe obligimin, të nxjerrë edhe masa shtesë që t'i detyrojnë që avancat të mbyllen në periudhën e paraparë.

Ju faleminderit! Kjo ishte ajo që desha ta them.

KRYESUESI: Ju faleminderit, zoti Sadriu!

Unë i kisha thirrur kryetarët e komisioneve që t'i ndërpresin mbledhjet në kohën kur ka seancë Kuvendi dhe mendoj se, nëse ndodhë që të mbahen mbledhjet gjatë seancës, duhet t'u hiqet mëditja të gjithëve edhe për pjesëmarrje në seancë edhe në komisione. Ne nuk mund ta vazhdojmë punën në Parlament pa kuorum dhe tani kanë dal tri komisione që të mbajnë mbledhje. Unë e kuptoj se e kanë pasur të caktuar, por po ju ftoj që ta shtyjnë mbledhjen për një orë derisa ta kryejmë seancën e pastaj të vazhdojnë. Ju faleminderit!

Tani sipas radhës janë përfaqësuesit e grupeve parlamentare.

Në emër të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike të Kosovës, fjalën e ka deputeti Ramiz Lladrovci.

RAMIZ LLADROVCI: Ju faleminderit, nënkryetar!

I nderuar ministër,

Të nderuar kolegë deputetë,

Edhe Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës, ka shqyrtuar raportin vjetor të auditimit për vitin 2010, të proceduar nga Zyra e Auditorit të Përgjithshëm. Ky raport përmban zbatimin që Qeveria i ka bërë buxhetit të vitit 2010 dhe pasqyrat vjetore financiare të buxhetit të Kosovës për këtë periudhë.

Kualifikimi i auditimit i dhënë nga ZAP është opinion i pakualifikuar, më pozitiv dhe tregon për transparencën e institucioneve në shfrytëzimin dhe menaxhimin e financave publike. Sipas raportit të ZAP-it, opinionit i përgjithshëm për pasqyrat vjetore financiare, është në harmoni me Ligjin për menaxhimin e financave publike, si dhe përgjegjësitë, udhëzimet e zbatuara administrative në pajtim me standardet ndërkombëtare.

Këto pasqyra paraqesin pamje të vërtetë dhe të drejtë të depozitës financiare të buxhetit të konsoliduar të Kosovës.

Grupi Parlamentar i PDK-së, përkrah raportin me rekomandime nga ana e ZAP-it, dhe fton të votohet, por ruan mendimin se opinionet e auditimeve të organizatave të caktuara buxhetore janë të anshme apo politike nga ana e Auditorit të Përgjithshëm. Si për shembull, opinionit për Ministrinë për Kthim dhe Komunitete, opinionit për Ministrinë e Administrimit Publik Lokal ose ai institucionit të Avokatit të Popullit.

Për më tepër, ka raste kur ZAP-i ka angazhuar kompani private të auditimit ku auditorët e tyre janë treguar shumë joprofesionalë, nuk e përcjellin në standard të caktuar dhe kjo të bën të dyshosh në cilësinë dhe vërtetësinë e atyre raporteve. Duhet të jetë edhe detyrë e ZAP-it, që të krijojë standarde të cilat duhet t'i përcjellin ato kompani kur të bëjnë auditimin e organizatave buxhetore të Kosovës.

Zyra e Auditorit të Përgjithshëm ka angazhuar kompaninë „Grand Torton“ për t'i audituar pasqyrat financiare, për shembull të komunës së Lipjanit dhe KPMG SHPK për atë të komunës së Deçanit, për vitin 2010.

Kompania „Grant Thornton“ ka dhënë kualifikimin e auditimit me mohim i opinionit për komunën e Lipjanit. Komuna e Lipjanit, siç dihet në raporte ka dërguar komentet e tyre të cilat shprehin jo pajtueshmërinë më shumë nga të gjeturat dhe konstatimet e auditorit. Praktika e kësaj kompanie ka qenë në kundërshtim me standardet ndërkombëtare të auditimit të hartuara nga INTOSAI. Ata kanë shkuar në formën e shablloneve që zbatohen te kompanitë private dhe nuk e kanë kuptuar se kanë të bëjnë me organizatat buxhetore, prandaj, konstatimet e tyre janë konfuze dhe jo të sakta.

Lidhur me rekomandimet që janë bërë komunës së Lipjanit, nga kjo kompani auditimi, komuna është pajtuar vetëm te rekomandimi për zyrtarin e aseteve dhe Komisionin e formuar për regjistrimin e pasurisë, që nuk i kanë kompletuar të gjitha informatat lidhur me pasuritë ekzistuese të komunës.

Format e faturimit të përgatitura dhe të rekomanduara nga Thesari, që i ka pasur në zbatim komuna, me të cilat njihet kodi hyrës dhe sektori se ku e hyra është arkëtuar, nuk janë njohur dhe nuk janë pranuar si të rregullta nga kjo kompani e auditore dhe është rekomanduar si e gjetur, e që në fakt fare nuk ekziston e gjetura. Ndërsa, në Zyrën e Prokurimit, sipas kompanisë së auditimit, janë regjistruar si e gjetur mungesa e ekzekutimit të tenderit e që realisht edhe pse ato kanë ekzistuar në dosje, u janë dhënë kopjet e tyre në rastin e dorëzimit të komenteve nga ana e menaxhmenitit.

Po ashtu Kompania KPMG-SHPK, ka dhënë kualifikimin e auditimit me mohim të opinionit për Komunën e Deçanit. Edhe kjo kompani e auditimit nuk ka bërë shfletim të mirëfilltë të pasqyrave financiare, por vetëm ka shkuar në formën e shablloneve të pasqyrave të cilat përdoren për biznese si dhe nuk ka futur asnjë shpjegim të zyrtarëve të komunës. Draft-raporti që është proceduar, për shembull kësaj komune, ka qenë i një komune tjetër dhe pas reagimit të përfaqësuesve të komunës, atyre i është proceduar i njëjti drafat-raport, por me emër të komunës së Deçanit.

ZAP-i me një të gjetur në prokurim dhe me disa mangësi teknike në administrim të personelit dhe provave të cilat ende nuk janë të revalizuara e as të përcaktuara se kujt i takojnë, ka dhënë kualifikimi e auditimit me mohim të opinionit, pra auditimin në këtë komunë si dhe në shumë komuna tjera që janë audituar nga kompani private të auditimit, është kryer nga njerëzit joprofesional.

Konsideroj se pavarësia e ZAP-it, domosdoshmërisht duhet ruajtur, por megjithatë ZAP-i i raporton Parlamentit dhe duhet bërë çmos që auditimi i jashtëm të fuqizohet dhe të jetë profesional. ZAP-i duhet të vazhdojë fuqizimin e mëtutjeshëm profesional, i cili do të mund të rezultonte me shtimin e numrit të auditiveve, performancës dhe menaxhimit dhe jo vetëm të rregullsisë.

Janë për t'u vlerësuar përparimet e Qeverisë së Kosovës në reflektimin e rekomandimeve të ZAP-it. Po ashtu është për t'u vlerësuar transparenca e Qeverisë së Kosovës lidhur me shpenzimin e parasë publike. Inkurajojmë Qeverinë që të forcojë edhe më shumë kontrollin e brendshëm rreth menaxhimit të parasë publike në mënyrë më të mirë të mundshme. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit!

Në emër të Grupit Parlamentar “Vetëvendosje”, deputeti Afrim Hoti.

AFRIM HOTI: Përshëndetje për deputetët!

Raporti vjetor i auditimit për vitin 2010, i hartuar nga Zyra e Auditorit të Përgjithshëm, konsiston në vërtetimin e zbatimit të buxhetit, konkretisht mënyrën e ndarjes, menaxhimit dhe shpenzimet e mjeteve buxhetore nga Qeveria dhe organizatat buxhetore. Përveç kësaj, Zyra e Auditorit ka verifikuar ndërhyrjet politike të institucioneve të pavarura përmes ndarjes së mjeteve buxhetore dhe rekrutimin të stafit të partive në pushtet, me çka është dëmtuar rëndë profesionalizmi në këto institucione dhe si pasojë e kësaj, ka pasur ngecje në kryerjen e punëve të përcaktuara me Kushtetutë dhe me ligje. Mirëpo, Zyra e Auditorit të Përgjithshëm, përveç verifikimit të këtyre parregullsive, ka paraqitur edhe rekomandimet të cilat nëse do të zbatohen në përpikëri nga ata që i dedikohen, atëherë rruga do të jetë më e lehtë drejt integritetit në Bashkimin Evropian. Si rrjedhojë e kësaj, ne do t'i paraqesim disa çështje të përcaktuara në raport dhe që kanë rëndësi të veçantë.

Te menaxhimi i buxhetit, raporti ka evidentuar raste ku shpenzimet janë rritur në mënyrë të theksuar në tremujorin e vitit të fundit, krejt kjo si pasojë e planifikimit të dobët që bëjnë organizatat buxhetore dhe kjo tregon se ato luftojnë në fund të vitit që

t'i shmangen suficitit. Edhe kjo tregon qartë mungesën e ideve në zhvillimin ekonomik të vendit.

Auditori ka identifikuar dobësitë e funksionimit të prokurorimit publik, këto mangësi kanë të bëjnë me lidhjen e kontratave, pa siguruar fondet e nevojshme, gjë që rritë rrezikun që organizatat buxhetore të mos arrijnë t'i kryejnë me kohë obligimet e parapara, me kontrata, të vendosen para ndëshkimeve të mundshme. Ka pasur mospërgatitje të duhur të dosjeve të tenderit që ka dërguar drejtpërdrejt në favorizimin e ndonjë oferte nga organizata buxhetore. Gjithashtu, nuk ka pasur kontroll të mjaftueshëm në vlerësimin e tenderëve e cila shpie në dhënien e kontratave në mungesë të ofertave të përgjegjshme e tjerë.

Zyra e Auditorit të Përgjithshëm, ka identifikuar te sistemi shërbyes civil moskrijimin e akteve nënligjore nga Ministria e Administratës Publike, që është kusht për zbatimin të detajuar efektiv dhe efikas të Ligjit për shërbimin civil dhe Ligjin për pagat e shërbyesve civilë. Përveç kësaj, auditori i përgjithshëm ka evidentuar mosrespektim të procedurave të regrutimit të shpallura në konkurs. Për shembull, nuk është respektuar përvoja e punës, kanë munguar referencat për fushatë përkatëse, nuk ishte informuar paneli intervistues, ka munguar shpallja e konkursit në shtyp e tjerë. Më tepër ka pasur edhe të punësuar pa konkurs.

Rrjedhimisht, kjo ka dëmtuar lirintë dhe të drejtat e njeriut të parapara me ligje dhe konventa ndërkombëtare. Është ngarkuar buxheti i organizatës dhe ka ngecje me efektivitetin dhe efikasitetin e punëve që duhet të kryhen dhe raporti evidenton shumë ndërhyrje politike në institucionet e pavarura në aspektin e ndarjes së mjeteve, ashtu edhe në atë të punësimit. Sipas raportit, kufizimet buxhetore nga Ministria e Financave dhe përkufizimi i kufijve buxhetor, pa marrë parasysh kërkesat buxhetore të institucioneve të pavarura, paraqesin cenim të pavarësisë institucionale dhe financiare, që është në kundërshtim me Ligjin mbi menaxhimin e financave publike, neni 66.

Përsëri raporti pas vendimit të Qeverisë, Ministria e Financave ose ka reduktuar, ose ka tërhequr buxhetin nga pesë institucionet e pavarura. Për më tepër, institucionet e pavarura nuk kanë mekanizma institucional përmes të cilëve mund të mbrojnë veten nga ndërhyrjet qeveritare në buxhetet e tyre. Përveç ndërhyrjeve në aspektin financiar, ndikimin në institucionin e pavarur, vazhdon edhe në punësim të personave të afërt me pushtetin. Kjo shihet në emërimin e tyre, në bordet e këtyre institucioneve, në përzgjedhjen e drejtorëve ekzekutiv.

Në fund, paraqitja e këtyre çështjeve që kanë të bëjnë me menaxhimin dhe shpenzimet e buxhetit të vitit 2010, tregon qart orientimin e ushtrimit të pushtetit ekzekutiv, mirëpo, Grupi Parlamentar i lëvizjes “Vetëvendosje” do të votoj pro raportin me të gjitha rekomandimet e cekura më lartë. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju Faleminderit! I kërkoj falje zotit Sadriu. Në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, deputeti Sadriu.

ALI SADRIU: Ju faleminderit, zoti nënkryetar!

Ne sot po shqyrtojmë raportin e Zyrës së Auditorit Gjeneral. Mendoj se ka qenë më mirë të ishte prezent dhe ta paraqet vetë drejtori gjeneral i Zyrës së Auditorit dhe t'i jepet shansi që ai ta mbrojë, nëse jo në këtë rast, në raste tjera ju lutem të jetë praktikë. Ai më së miri do t'i reflektonte të metat në të cilat kushdo qoftë do të gjente diçka dhe arsyetimet do të ishin më adekuate.

Unë nuk pretendoj ta marr atë rol, por jam për atë që ai të jetë prezent dhe ta mbrojë. Te propozimi, vërtet Zyra e Auditorit Gjeneral, në këtë raport ka dhënë dy rekomandime, që të dyja janë nisma, kërkesë për nisëm e ndryshimit të dy ligjeve. Është fjala për ndryshimin e Ligjit mbi menaxhimin e kompanive publike tek procedurat e përcaktimit të përzgjedhjes së kompanisë e cila e bën auditimin e kompanive publike. Nuk është e natyrshme dhe nuk është në rregull që këtë ta bëjë vetë kompania publike. Ka dhënë dy propozime, propozimi i parë është që këto procedura t'i udhëheqë Njësia për Monitorim, që është pranë Ministrisë për Ekonomi dhe varianti i dytë është të jetë një komision i përbërë prej Njesisë për Monitorim, Njesisë për Harmonizim të Auditimit dhe Zyra e Auditorit Gjeneral, do të thotë tri këto të qojnë nga një delegat në përzgjedhjen e kompanive të cilat do të bëjnë auditimin e kompanive publike.

Ka dhënë po ashtu edhe një rekomandim dhe kërkon që të fillojë procedura e ndryshimit për Ligjin e pushtetit lokal. Fjala është për një dispozitë, kërkon që t'i rikthehet funksioni i drejtorit ekzekutiv. Arsyetimet do t'i jepte ai shumë më gjerë. Arsyeja thelbësore është se stafi civil është ai që merret me këto procese dhe profesionalizmi do të vijë në shprehje shumë më fuqishëm dhe lëshimet do të jenë më të pakta. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit!

Në emër të Grupit Parlamentar të Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës, kush e do fjalën? Fjalën e ka deputeti Bali Muharremaj.

BALI MUHARREMAJ: Ju faleminderit, zoti kryetar!

Të nderuar kolegë deputetë,

Grupi Parlamentar i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës, ka shqyrtuar Raportin vjetor të auditimit për vitin 2010 të Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm.

Ky raport na jep një pasqyrë më të qartë të shpenzimit të parave publike dhe menaxhimit të buxhetit të konsoliduar të Kosovës. Raporti ka nxjerr në pah shumë parregullsi dhe keqmenaxhim të buxhetit nga organizatat buxhetore. Ne do të donim t'i potenconim tri nga këto mangësi më të shprehura të cilat po dëmtojnë buxhetin dhe në vazhdimësi po përsëriten.

Së pari shpalosja e pasqyrave financiare dhe përgatitja e tyre në harmoni me standardet ndërkombëtare të auditimit, është duke qaluar që një kohë të gjatë. Është i vogël numri i organizatave buxhetore të cilat shpalosin drejt këto pasqyra dhe konform kërkesave ligjore.

Së dyti, sistemi i menaxhimit të pasurisë nuk është duke funksionuar. Shumica e organizatave buxhetore nuk kanë përgatitur listë të plotë dhe të saktë të pasurive dhe pronave, si dhe nuk kanë menaxhuar me pasurinë e tyre me pajtim me ligjet dhe rregulloret në fuqi. Mungojnë udhëzimet e brendshme të organizatave buxhetore mbi vlerësimin, tjetërsimin dhe inventarizimin e pasurive.

Së treti, rekomandimet e Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm, nuk po trajtohen me seriozitetin e duhur. Si pasojë këtu kemi implementim të ulët të rekomandimeve dhe përsëritjen e tyre nga viti në vit. Për më tepër, organizatat buxhetore nuk po i përfillin në tërësi as rekomandimet e vet auditorit të tyre të brendshëm.

Grupi Parlamentar i Aleancës për Ardhmerinë e Kosovës, në parim do ta votojë këtë raport.

KRYESUESI: Ju faleminderit!

Grupi Parlamentar, Koalicioni Kosova e Re, zoti Mustafa e ka fjalën.

Regjia, deputetit Mustafa fjalën!

Me kartelën e deputetit Rugova. Regjia, shtypeni te kartela e deputetit Ukë Rugova.

MUHAMET MUSTAFA: Ju kërkoj falje për këto probleme, se e kam harruar kartelën, kështu që...

Të nderuar kolegë deputetë,

I nderuari kryesues,

I nderuari ministër,

Mendoj se ne sot para vetit kemi një raport cilësor, mjaftë profesional. Pra, raporti është punuar mirë, por gjendja në këtë sferë ende duhet të përmirësohet. Ajo që është pozitive, që duhet të konstatojmë sot, ka të bëjë me faktin se Auditori i Përgjithshëm dhe zyra e tij po ngritin kapacitetet dhe nivelin e profesionalizmit dhe vëllimin e punës, prej vitit në vit dhe kjo ka një rëndësi jashtëzakonisht të madhe për transparencën dhe llogaridhënien, si parime të rëndësishme të zhvillimit institucional në Kosovë.

Gjithashtu, një rrethanë pozitive është se edhe praktika e auditimit të brendshëm nëpër organizatave buxhetore ka një zhvillim pozitiv, ndonëse ende këtu duhet të bëhet shumë. Mendoj se ne si grup parlamentar mbështesim konkluzat që i ka propozuar ky raport. Gjithashtu, ndoshta do të duhet të precizohen pak më mirë konkluzat në disa sfera. Vetë fakti se nëse nxjerrim një statistikë prej 81 raporteve, del se vetëm 18% të raporteve kanë kaluar pa vërejtje, 38% janë me vërejtje serioze dhe 44% me vërejtje pak më të vogla.

Në këtë sferë ne duhet të punojmë shumë më tepër. Në fakt, edhe në raport theksohet se ende në institucionet e Kosovës dhe në agjencitë buxhetore ekziston një mjedis i dobët kontrolli. Kjo ndoshta duket si fjali e thjeshtë, por është shumë serioze dhe ne duhet të brengosemi me të. Prandaj, unë do të propozoj që Kuvendi sot të marrë një konkluzë që të gjitha agjencitë buxhetore dhe ministritë të përfundojnë regjistrimin e saktë dhe sipas standardeve kontabël të pasurisë së Kosovës, sepse kjo është një nga vërejtjet themelore gati në secilin raport, të cilin e kemi shqyrtuar edhe në Komisionin për Mbikëqyrje të

Financave Publike dhe gjetiu, pra është për t'u habitur se kaq vjet kanë kaluar dhe ne ende nuk e kemi të regjistruar, të inventarizuar pasurinë publike të institucioneve.

Prandaj, mendoj se kjo nuk duhet të tolerohet më tutje dhe ne duhet të caktojmë sot një datë. Unë do të propozoj që të jetë deri më 30 qershor të përfundojë inventarizimi i plotë, regjistrimi i plotë i pasurive të të gjitha institucioneve sipas standardeve të kontabilitetit dhe ky do të duhej të ishte një obligim.

Çështja e dytë për brengosje është se konkluzat të cilat i jep Auditori i Përgjithshëm pas kontrolleve që bën, nuk merren shumë seriozisht dhe nuk ka një zbatim të rregulloreve lidhur me përgjegjësinë, llogaridhënien për lëshimet në mbajtjen e pasqyrave financiare, mbajtjen e evidencës për pasuritë. Edhe këtu do të duhej ndoshta të bëhet një analizë më e thellë, ku janë problemet, përse nuk ndërmerren masa pas kontrolleve lidhur me evitimin e problemeve dhe zbatimin e rekomandimeve.

Përndryshe, nuk do të kishte kuptim që ne prej vitit në vit të marrim pothuajse të njëjtat vërejtje. Prandaj, me këto dy propozime dhe duke i mbështetur dhe propozimet tjera, unë do të përfundoj diskutimin dhe do të theksoj se ne do ta votojmë raportin. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Në emër të Grupit Parlamentar SLS, deputeti Millosavleviq.

SAŠA MILOSAVLJEVIČ: Hvala, gospodine predsedavajući!

I parlamentarna grupa Samostalne liberalne stranke je razmotrila godišnji izveštaj iz kancelarije Generalnog revizora, i mi čemo na glasanju podržati ovaj izveštaj iz kancelarije Generalnog revizora. Hvala!

KRYESUESI: Faleminderit! Grupi Parlamentar "6+", deputetja Balje.

DUDA BALJE: Zahvaljujem!

Parlamentarna grupa "6+" je vršila razmatranje godišnjeg izveštaja kancelarije Generalnog revizora za godinu 2010. Smatramo da pored uočenih anomalija i prednosti koje su ostvarene u toku ove godine, očekujemo da će u narednoj godini biti stvari dosta bolje i podržavamo ovaj izveštaj. Hvala!

KRYESUESI: Faleminderit! Radha është e deputetëve. Fjalën e ka deputeti Lutfi Haziri.

LUTFI HAZIRI: Faleminderit, zoti nënkryetar dhe kryesues!

Të nderuar deputetë,

U bë pak si traditë puna e raporteve të kalojnë vetëm formalisht, sa për të kënaqur ligjin edhe rregulloret e brendshme, përderisa kjo temë është shumë e rëndësishme. Unë do ta prek domenin e borxheve të padeklaruar.

Edhe këtë vit auditori e përmend, pasurimi i borxheve është problem serioz, pas pasurimit të aseteve komunale, të aseteve në përgjithësi. Përderisa, pasuria e paluajtshme ka vlerë të paçmueshme, e kemi lëvizje jashtë ligjit në shumicën e komunave, sot s'po përmendi shumë, po përmendi vetë faktin e borxheve që organizatat buxhetore në nivel lokal, në

veçanti po e çojnë institucionin e komunës deri në falimentim. Duke pasur parasysh se po bien zgjedhjet shumë shpesh dhe është bërë modë që me telefon e me sms të thirren kompanitë për të punuar, që është mënyra më e keqe e mundshme e futjes në obligime të komunës apo futjen në borxhe, i ka detyruar shumicën e komunave që auditori të hulumtojë e mos të gjejë fakte, sepse nuk i kontrollojnë sms-at, prokuroritë i kontrollojnë dhe zakonisht thotë: “pasurimi i borxheve mungon nga ana e komunës” dhe nuk merren me atë problem.

Kemi komunë që shkon, prej 1 000 000 deri në 12 000 000 euro borxh të padeklaruar, që është vepër penale dhe me të cilën duhet të merremi, sepse menaxhimi mandej i krejt kësaj shkon jashtë procedurave ligjore. Nëse për një projekt komuna është e obliguat t’i zotojë mjetet dhe mandej të bëjë shpalljen publike për të organizuar procedurat e tenderit, këtu po ndodh e kundërta. Njëherë jepet puna, kryhet puna, bëhen marrëveshje gojore dhe formale në disa raste, që është edhe më keq, kryhen punët dhe mandej organizohet procedura, kur Qeveria lëshon para. Qeveria zakonisht në rishikim lëshon para, këtë vit s’ka pas rishikim, ka pasur një rialokim të mjeteve për t’i shlyer obligimet mbi bazë të favoreve, por që është jashtëzakonisht serioze.

Çka prodhon auditori? Prodhon rekomandime dhe rekomandime kryesisht në përmirësimin e procedurave dhe zbatimin e ligjit. Kush merret me këto, kush i mbikëqyrë, cili është organi që do të duhej të merret? Askush.

Ministria e Financave me vetë faktin që lejon komunën të hyjë në shpenzime dhe shpenzimet kryesisht shkojnë në shërbime dhe mallra, kemi institucion i cili ka 417 kontrata në vepër. 417 kontrata në vepër është shpenzim enorm për një institucion komunal, sepse nuk do të duhej lënë askënd të ketë kontratë në vepër jashtë periudhës kohore prej 3 muajve ose edhe njëherë një mundësi tjetër 6 muaj, derisa të kryhet ajo punë. Përndryshe, institucioni i kontratës në vepër në shëndetësi primare, në arsim dhe në sektorë të tjerë është kryesisht i ndërtuar mbi bazë të favoreve e jo mbi bazë të nevojës që kanë këto institucione. Praktikisht shkalla prej Ministrisë së Financave deri te organizata buxhetore është deformuar seriozisht, por alarmi vjen nëse nuk e lexojmë Raportin e Auditorit drejtë, alarmi vjen kur një ditë falimentojnë disa kompani dhe ato kompani shkojnë me punëtorë në komunën e mbyllin komunën, sepse ata e dinë që borxhet janë aty.

Atëherë, është seriozisht detyrë emergjente që dikush të merret me këtë punë. Nëse ministrat nuk merren, në këtë rast ministri i Pushtetit Lokal dhe ministri i Financave, atëherë kryeministri e ka detyrë të parë Raportin e Auditorit ta lexojë drejt dhe të bëjë urdhëresën e parë që ta disiplinojë institucionin në kuptimin financiar dhe buxhetor. Nëse kjo nuk ndodh, atëherë do ta shohim shumë shpejt që problemet e trazirat do të fillojnë pa të drejtë, por për shkak të këtyre problemeve që është bërë modë, fjala e dhënë është që duhet të mbahet, në rastet tjera nuk mbahet, sepse e dimë nëse e bëni një intervistë interne me këto kompani që ju kanë marrë punët në mënyrë jo të rregullt, në premtim dhe i shihni se cilat janë kryer, mbas një muaji keni për ta parë procedurën e tenderit i cili mundohet të mbulojë diçka dhe problemet e tilla serioze janë hasur shumë, por edhe më tutje së paku Parlamenti sot duhet të dalë me rekomandim që rekomandimet e auditorit zbatohen

në tërësi edhe njëherë ta konfirmojë dhe të obligohen ministrat dhe kryeministri ta trajtojnë këtë çështje. Aty ku ka kaluar jashtë normales, vërtet duhet të merren masa të suspendimit të menjëhershëm, së paku të autoritetet që janë të certifikuara mos ta lejojnë një çështje të tillë, aty ku ka pasur presion politik, sigurisht që partitë duhet të merren më seriozisht me këtë problem. Faleminderit, shumë!

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka deputetja Dibra.

VALBONA DIBRA: Faleminderit, nënkryetar!

I nderuar ministër,

Të nderuar kolegë deputetë,

Raporti vjetor i auditimit, i përgatitur nga Zyra e Auditorit Gjeneral për pasqyrat vjetore financiare të Qeverisë, për buxhetin e Kosovës, tregon në mënyrë të qartë se pasqyrat financiare në të gjitha aspektet materiale janë në harmoni me Ligjin për menaxhimin e financave publike, përgjegjësitë dhe me udhëzimet e zbatueshme administrative në pajtim me standardet ndërkombëtare të kontabilitetit për sektorin publik, si dhe paraqesin pamje të drejtë dhe të vërtetë të pozitës financiare të buxhetit të Kosovës.

Në bazë të punës në terren dhe në harmoni me standardet ndërkombëtare të auditimit, Auditori ka dhënë opinion të pakualifikuar për pasqyrat financiare të buxhetit të Kosovës, për vitin 2010.

Zyra e Auditorit gjatë vitit 2010 ka audituar 89 organizata buxhetore, ku ka mbuluar të hyrat në 99% dhe shpenzimet në 87%, çka do të thotë që kapacitetet e Zyrës së Auditorit Gjeneral janë përmirësuar sa i përket auditimeve të rregullsisë. Krahasuar me vitin 2009, numri i auditimeve të rregullsisë është rritur për 19. Është brengosës fakti se numri i auditimeve të performancës është ende i ulët, ku gjatë vitit 2010 janë bërë vetëm 3 auditime të performancës. Duke u bazuar në numrin e vogël të auditimit të performancës, është në interes të organizatave buxhetore ngritja e numrit të këtyre auditimeve.

Nga gjithsej këto auditime shihet se performanca në shpenzime të parasë publike është përmirësuar nga viti në vit. Kjo vërehet nëse i krahasojmë opinionet e dhëna në vitin 2009 me atë të vitit 2010, ku ka pasur përmirësime të dukshme. Për krahasim, në vitin 2009 janë dhënë 29 mohime të opinioneve, ndërsa në këtë vitin 2010 janë dhënë vetëm 9. Kjo dëshmon se institucionet tona po shkojnë drejtë përmirësimit të menaxhimit të parasë publike.

Po ashtu, krahasuar me vitet e mëparshme, cilësia e raportimit të jashtëm financiar po përmirësohet sidomos në komunat e Kosovës. Përmirësim ka pasur edhe në zhvillimin e sistemeve të auditimit të brendshëm. Sa i përket kontraktimit të komunave të auditimit nga ana e Zyrës së Auditorit Gjeneral për komuna, unë pajtohem me kolegun Lladrovci se Zyra e Auditorit duhet të bëjë më shumë monitorim rreth këtyre auditimeve.

Dhe, në fund, konsideroj se raporti është i përgatitur në mënyrë profesionale dhe unë do ta votoj dhe njëkohësisht kërkoj ose ftoj edhe kolegët tjerë që ta mbështesin këtë raport. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka deputetja Lama.

ALMA LAMA: Faleminderit, zoti kryesues!

Shumë nga vërejtjet në lidhje me Raportin e auditimit u thanë këtu nga deputetët dhe nuk dua të bëj përsëritje. Unë do jap disa rekomandime, mirëpo do të ndalem fillimisht në dy çështje që dua t'i veçoj nga ajo që ka konstatuar Raporti vjetor i auditimit.

Pra, ky raport ka konstatuar në një përmbledhje të përgjithshme se prokurimi mbetet problemi thelbësor. Është një nga sfidat kryesore në sistemin e kontrollit të brendshëm të financave publike, thuhet saktësisht në këtë raport.

Një vërejtje po kaq e rëndë erdhi edhe nga Raporti i Progresi, të cilin e shqyrtuam para disa ditësh. Pra, çështja e tenderëve jo të rregullt vazhdon të mbetet alarmante, paraja publike vazhdon të shpërdorohet dhe, për më tepër, monitorimi i kontratave mbetet shumë i dobët. Kjo është konstatuar në raport dhe ky vazhdon të mbetet problemi themelor që kanë institucionet këtu.

Çështja tjetër e rëndësishme, që gjithashtu dua ta veçoj dhe që përmendet në raport, është se rekomandimet e Auditorit të Përgjithshëm nuk merren seriozisht ose siç shprehet auditori : “nuk janë duke u adresuar në mënyrë të mjaftueshme”, pra shkeljet përsëriten nga viti në vit, llogaridhënia mungon dhe ndëshkimi për përgjegjësit mungon. Ne si Kuvend duhet të rrisim shkallën e mbikëqyrjes mbi Qeverinë, pasi abuzimet janë shumë të mëdha.

Mua më duket se edhe ne si Kuvend nuk po e marrim shumë seriozisht punën e mbikëqyrjes së Qeverisë. Ndërsa, për sa i përket institucionit të Auditorit të Përgjithshëm, është një nga institucionet më të pavarura që kemi dhe ne si Kuvend duhet të bëjmë të gjithë presionin e nevojshëm që ky institucion të përforcohet dhe t'i ngjajë institucioneve homologe në vendet e tjera të perëndimit. Unë uroj që kjo pavarësi, pra më e madhe e krahasuar me disa institucionet të tjera të pavarura ose që do të duhej të ishin të pavarura, të mos jetë për shkak se udhëhiqet nga një ndërkombëtar, por dua të besoj që edhe stafi që punon ka krijuar integritetin e nevojshëm për t'u përballur me presionet politike. Për fat të keq, presionet politike janë të forta mbi të gjitha institucionet e pavarura dhe sa kohë që kemi një situatë të tillë, jemi shumë larg ndërtimit të shtetit ligjor.

Mirëpo, pavarësisht fjalëve të mira që thashë për punën e auditorit, unë i kam disa vërejtje, megjithatë. Pasi kam vënë re se gjatë shqyrtimit të raporteve ky institucion ka përdorur në disa raste standarde të ndryshme të auditimit, kam parasysh këtu disa auditive, ku me gjithë parregullsitë e mëdha dhe keqpërdorimin e madh të parasë publike, auditori ka bërë një vlerësim pozitiv për institucionin në fjalë, si p.sh. për Ministrinë për Kthim dhe Komunitete, ku parregullsitë janë aq të mëdha, sa ajo është bërë pjesë e hetimeve. Po kështu, Ministria e Ambientit rezulton me shkelje shumë të mëdha, mirëpo vlerësimi duket disi i zemërgjerë nga Zyra e Auditorit.

Ndërkohë, kemi pasur institucione me një buxhet shumë të vogël, si p.sh. Akademia e Shkencave, që nuk ka pasur parregullsi dhe ka marrë pak a shumë të njëjtën notë me institucionet që përmenda më sipër. Pra, unë dua t'i tërheq vërejtjen auditorit për një vlerësim real dhe të paanshëm për të gjitha institucionet.

Së dyti, do t'i sugjeroja Auditorit të Përgjithshëm që ta përqendronte punën e tij të auditimit në kompanitë publike dhe institucionet të cilat qarkullojnë shumë para ose kanë një buxhet shumë të madh, si p.sh. PTK, KEK-u, Ministria e Transporteve etj. Natyrisht që ata përzgjedhjen e bëjnë në mënyrë të pavarur, mirëpo është e rëndësishme që institucionet që kanë buxhet më të madh, të futen në një skaner më gjithëpërfshirës dhe si ne, ashtu dhe qytetarët të kenë një pasqyrë më të detajuar rreth mënyrës se si shpenzohet paraja publike.

Po kështu, janë tepër të rëndësishme raportet e performancës. Aktualisht auditori ka shumë pak kapacitete për të bërë raporte të tilla performance, ku realisht i hyhet me themel disa institucioneve ku konstatohet se kanë shkelje. Pra, në rast se raportet që kemi aktualisht janë disi më sipërfaqësore, aty ku këto raporte konstatojnë shkelje, kanë nevojë për raporte performance për të parë më saktësisht se çfarë po ndodh në ato shkelje.

Së treti, është tepër e rëndësishme të Auditori i Përgjithshëm të bashkëpunojë me prokurorinë. Raportet në të cilat konstatohen shkelje duhet të jenë lëndë e parë për hetime. A po ndodh kjo? Kam frikë se jo. Kjo situatë flet për një prokurori që ose iu nënshtrohet presioneve politike, ose ka frikë të hapë hetime, pra ka autocensurë, pasi e di se klima politike është e papërballueshme për të ndërtuar një shtet të së drejtës dhe të sundimit të ligjit.

Dhe, në fund, dua të bëj një sqarim se me duket po keqkuptohet nga deputetët, ne nuk jemi ata që miratojmë Raportin vjetor të auditimit, pasi ky është raporti i një institucioni të pavarur, por ne miratojmë rekomandimet që i jep Komisioni për Mbikëqyrje Financiare në lidhje me punën e mëtejshme. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Deputeti Morina e ka fjalën.

SALIH MORINA: Faleminderit, kryesues!

Të nderuar kolegë deputetë,

Së pari, kam një vërejtje se ne jemi duke e diskutuar një raport i cili ka të bëjë me buxhetin vjetor të gjitha organizatave buxhetore dhe këtu po shohim se prej 6 zëvendëskryeministrave, asnjëri prej tyre nuk është prezent dhe njëkohësisht është dashur që patjetër të jetë ministri për Ekonomi dhe Financave dhe, po ashtu, ministri i Pushtetit Lokal.

Ky raport është bazë, në shërbim për të kërkuar llogari nga shpenzuesit publikë se si po e menaxhojnë paratë publike. Raporti i Auditorit të Përgjithshëm prezanton mjaftë të gjetura, ka dhënë rekomandime se si të përmirësohet gjendja, prandaj sot këtu do të duhej të kërkohej llogari në radhë të parë nga Qeveria, si shpenzues më i madh i buxhetit, dhe bartësi kryesor i një numri të madh rekomandimesh.

Ndërmarrjet publike dhe shoqërore vazhdojnë të bartin probleme, siç janë: grumbullimi i ultë i të hyrave, rritja e llogarive të ..., ndërkaq humbjet operative vazhdojnë të mbulohen nga subvencionet e pronarëve. Me këtë kuptojmë se nuk është bërë monitorimi i duhur i ndërmarrjeve e as nuk janë marrë masa në pajtim me parimet e transparencës, qeverisjes dhe llogaridhënies.

Fushat në të cilat pothuajse të gjithë shpenzuesit buxhetor vazhdojnë të jenë në nivel alarmues, mbetet prokurimi publik, kontrolli dhe menaxhimi financiar. Prandaj, ne duhet të kërkojmë nga të gjithë shpenzuesit buxhetor që të mos iu ikin përgjegjësi individuale dhe të sigurojnë përdorimin efikas të parasë publike. Mendoj se këtu duhet të shqyrtojmë edhe raportet individuale të auditimit për ato institucione që akoma përballen me të gjetura dhe nuk arrijnë të inpletojnë rekomandimet e dhëna nga Auditori i Përgjithshëm.

Ne kemi Zyrën e Auditorit të Përgjithshëm, një mekanizëm që në mënyrë të pavarur po bën një punë shumë profesionale duke prodhuar raportin me kualitete në kohë. Bazuar në këto raporte, ne mund të shohim se vit pas viti edhe menaxhimi financiar, edhe korniza ligjore janë duke u zhvilluar. Por, ne si Kuvend duhet të angazhohemi më shumë edhe në rastet e keq menaxhimit duhet të mbajmë qëndrime të palëkundura dhe të vëmë para përgjegjësisë.

Është mirë që ne si Kuvend të marrim një Raport Vjetor të Auditimit me kohë, me afat dhe cilësi të mjaftueshme. Auditori i Përgjithshëm e gjen cilësinë e praktikave të menaxhimit financiar dhe të kontrollit të një gjendje mjaftë alarmuese, që në disa fusha të rëndësishme, si prokurimi dhe menaxhimi financiar mund të bëjmë disa hapa pozitiv për sa i përket organizimit dhe kornizës ligjore. Që zbatimi i këtyre kërkesave të jetë ... ecje mjaftë e ngadaltë dhe se Qeveria ende nuk ka zhvilluar metodat e reja që do t'i ndihmojnë organizatat buxhetore për ta lexuar buxhetin në mënyrë racionale dhe ekonomike, është mirë që Auditori i Përgjithshëm i ka ofruar edhe Kuvendit dhe Qeverisë ndihmë të caktuar në rekomandimet që të merren parasysh, duke na bërë të aftë që në një mënyrë sistematike të adresojmë dobësitë në sistemin ekzistues, si dhe mangësitë në zbatimin e tyre.

Nuk është edhe aq e mirë që rekomandimet e dhëna nga Auditori i Përgjithshëm nuk janë adresuar me kohë në mënyrë të përshtatshme. Është e nevojshme që rekomandimet e dhëna nga Auditori i Përgjithshëm të merren seriozisht. Propozoj që Kuvendi të marrë parasysh të gjitha rekomandimet e dhëna Kuvendit nga komisionet relevante dhe që Kuvendi të kërkojë nga Qeveria që para datës 31 mars të vitit të ardhshëm të raportojë mbi atë se Qeveria ka pranuar dhe adresuar rekomandimet e dhëna, duke detajuar rezultatet që dalin nga ato, si dhe planet për çështjet që marrin kohë më të gjatë për t'u zbatuar. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Deputetja Mustafa e ka fjalën.

SALIHE MUSTAFA: Faleminderit, kryesues!

I nderuari ministër,
Të nderuar kolegë deputetë,
Më gëzon fakti se opinionin e përgjithshëm i Raportit vjetor të Auditorit të Përgjithshëm për buxhetin e Kosovës është opinion i pakualifikuar, çka do të thotë se pasqyrat financiare të buxhetit të Kosovës pasqyrojnë shpenzimet e rregullta të buxhetit të Kosovës për vitin 2010. Megjithatë, diskutimi im do të fokusohet në opinionin e Auditorit të Përgjithshëm për Ministrinë e Shëndetësisë, meqë rast konsideroj se ky raport nuk shpreh në mënyrë reale shpenzimin e buxhetit në sektorin e shëndetësisë.

Unë konsideroj se opinionin e auditorit nuk ka mundur të jetë korrekt dhe i besueshëm vetëm nga auditimi në Ministrinë e Shëndetësisë dhe në Qendrën Klinike Universitare, meqë auditori për krijimin e opinionit të tij nuk ka bërë ekzaminimin e transaksioneve në Ministrinë e Shëndetësisë, nuk ka marrë së paku asnjë mostër për testim në shëndetësinë sekondare, gjegjësisht në spitalet rajonale, por të gjeturat e veta i ka bazuar vetëm në të dhënat raportuese të Ministrisë së Shëndetësisë. Si rezultat i kësaj, vlerësoj se raporti i auditorit ka dhënë një pasqyrë jo dhe aq të saktë rreth shpenzimit të buxhetit në sektorin e shëndetësisë, pasi që gjendja në disa nga spitalet rajonale flet krejt ndryshe.

Me këtë rast dua të theksoj se kjo formë e auditimit nuk i kontribuon në mënyrën më të mirë ngritjes së përgjegjësisë dhe llogaridhënies së shpenzuesve të buxhetit të ndarë për sektorin e shëndetësisë, gjë e cila do të duhej të ishte pikërisht edhe synim kryesor i këtij raporti. Andaj, sugjeroj që auditimi i shpenzimit të buxhetit për sektorin e shëndetësisë në të ardhmen të jetë më gjithëpërfshirës, në mënyrë që t'i kontribuohet shpenzimit sa më të drejtë të këtij buxheti. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Deputeti Zemaj e ka fjalën, i fundit në radhë është Halit Krasniqi.

ARMEND ZEMAJ: Faleminderit, kryesues!

I nderuar ministër Mujota,
Kolegë deputetë,
Së pari, më lejoni të them që personalisht e vlerësoj qëndrimin e ministrit Mujota në ambientet e sallës së Kuvendit, duke marrë parasysh se ne po e shqyrtojmë Raportin e Auditorit të Përgjithshëm për vitin 2010, por e dyta, pa lënë ndonjë keqkuptim, e kuptoj, i cili nuk e merr përgjegjësinë politike për atë çka ka ndodhë në dikasterin e vetë dhe komplet për të gjeturat e Zyrës së Auditorit në nivel qeveritar. Pse po e them këtë? Sepse gjatë shqyrtimit të raportit dhe të raportit të përgjithshëm, si komision funksional kemi pasur deklarime të ministrave të caktuar që nuk e marrin përgjegjësinë politike për ato çka kanë ndodhë në vitin 2010, dhe kjo ka nënkuptuar se asnjë veprim nuk është ndërmarrë deri më tani, jo vetëm në aplikimin apo zgjidhjen e rekomandimeve të dhëna nga Zyra e Auditorit Gjeneral, por as në përgjegjësinë së paku administrative ndaj keqpërdorimeve që kanë ndodhur me parandë publike.

Tendenca e Qeverisë dhe e disa komuna që të gjeturat e ZAP-it t'i minimizojnë në krahasim me të gjeturat, tregon qartë vazhdimin e keqpërdorimeve dhe të keqmenaxhimit si në aspektin menaxherial, ashtu edhe në atë financiar.

Të nderuar kolegë deputetë,

Nëse në raport është paraqitur që po thuaj se më shumë se 50% e buxhetit shpenzohet në tremujorin e fundit, nuk lë të nënkuptohet se këto të gjetura kanë një domethënie tjetër, përpos keqpërdorimit të parasë publike.

E dyta, prej 100/100 të procedurave të prokurimit apo të tenderëve, po thuaj se çdo i dyti është apo vazhdohet me kontratë shtesë prej 10%, të cilat detyrimisht dhe në mënyrë shumë të qartë lënë hapësirë për keqpërdorim dhe për keqmenaxhim të parasë publike. Nuk do koment tjetër regjistrimi i pasurisë, edhe pse prej krijimit të institucioneve të pavarura edhe sot në të gjetura të këtij raporti tregon qartë se asnjë organizatë po thuaj se buxhetore nuk ka arritur që të bëjë regjistrimin e pasurisë, dosjet e personelit janë larg standardeve ndërkombëtare dhe rekrutimi i stafit komplet është politik dhe auditimi i brendshëm shihet si opozitë në raport me organizatën buxhetore.

Raporti tregon qartë një mori problemesh që janë në sferën e menaxhimit të brendshëm dhe shkelje të rregullave të prokurimit publik.

E dyta, sa i përket komunave, është për të ardhur keq se po thuaj se mohim opinionin, shumica reflektohet në nivelin komunal. Dhe këtu po e them pa ndonjë të keqe, ka privatizim të tërësishëm të buxheteve dhe të parasë publike në nivelin komunal dhe të pronës publike.

Nëse i atribuohemi në disa komunave në fjalë, pikërisht edhe komunës së Deçanit, tendenca e vazhdueshme që prona publike të shndërrohet në pronë private, sidomos duke anashkaluar të gjitha rregullat ligjore që kanë bërë në prokurimin publik, hidrocentralin mbi lumin Lumbardhë dhe shumë e shumë shembuj të tjerë. Po ashtu, edhe komuna e Lipjanit, e gjithë Kosova e di se si menaxhohet prona publike dhe si është menaxhuar në vitet e kaluara dhe këto janë të paraqitura fort mirë edhe në Raportin e Auditorit të Zyrës së Përgjithshme në nivel të përgjithshëm.

Kjo tregon qartë se reflektimi edhe i shoqërisë civile, po edhe i deputetëve, edhe i Qeverisë më shumë është fokusuar në nivelin qendror, se sa në nivelin komunal dhe për këtë arsye kemi mohim të opinionit.

Dhe, për fund, Zyra e Auditorit Gjeneral nga ana ime dhe shumë anëtarëve të komisionit ka marrë vërejtje kolegjiale, edhe pse si kategori kushtetuese dhe që udhëhiqet nga një ndërkombëtar, në përpilimin e raporteve dhe në të dhënat që ne po e quajmë në terminologji, opinionin i pakualifikuar ose me theksim të çështjes.

Ministria e Kthimit ka të gjetura që jo vetëm që kanë të bëjnë me lidhjen direkte me prokurorinë, por nuk do koment tjetër sepse janë publike. Ka edhe ministri tjerë dhe organizata tjerë buxhetore dhe opinionin është shumë po thuaj se i lehtë në raport me disa opinione që janë dhënë pa anashkaluar raportin e përgjithshëm. Andaj, ne edhe sot si Kuvend nuk e kemi kryer detyrën tonë, sepse ky raport veç i ka kalua procedurat dhe më

31 tetor është hy në fuqi. Kjo tregon edhe një vonesë të vetë Kuvendit dhe të punës që po e bëjmë dhe rekomandimet të cilat do të dalin do të jenë shumë të minimizuara dhe nuk do ta kenë efektin e vetë po të ishin marrë më seriozisht gjatë muajve për të cilat ka qenë afati i paraparë. Ju faleminderit, shumë!

KRYESUESI: Faleminderit! Deputeti Krasniqi, e keni fjalën!

HALIT KRASNIQI: Faleminderit, nënkryetar!

Përshëndetje për ministrin Mujota, një nga ministrat shumë të respektuar!

Nuk do të ndalem as te raportet e auditimit të rregullsisë dhe as në raportet e auditimit të performancës në Zyrën e Auditorit të Përgjithshëm, por do të ndalem te konstatimet e Komisionit për Mbikëqyrjen e Financave Publike në Raportin vjetor të auditimit për vitin 2010 nga Zyra e Auditorit të Përgjithshëm, sepse janë mjaftë serioze. Veçanërisht do të merrem me konstatimin e komisionit se ka opinione të pakualifikuara në opinionet e auditimit.

Angazhimi i kompanive private për auditim për dy komunat që u morën shembull, tregon më së mirë se këto praktika do të ndryshohen dhe këto vërejtje duhet të merren seriozisht nga të gjithë kompetentët.

Në Zyrën e Auditorit të Përgjithshëm ka shkelje të kritereve edhe në institucionin e konkursit në rastet e rekrutimit të stafit të Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm dhe kjo praktikë duhet të ndryshohet, sepse sjell cilësi më të avancuar në përpilimin e raporteve vjetore dhe përgjithësisht në punën e Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm.

Nuk do t'i përsëris parafolësit e mi dhe me kaq do ta përfundoj fjalën time.

KRYESUESI: Faleminderit!

Ne i kem mbyllur diskutimet. Paraqitja mbasi të mbyllet diskutimet, është e pavlefshme. Mund të bëni replikë, zoti Sadriu. Zoti Sadriu, e ka fjalën. Jeni paraqitur me vonesë.

ALI SADIU: Desha vetëm të konstatoj që vlerësimet që i dha zoti Ramiz Lladrovci, në të cilat u thirr edhe kolegu tash, janë vlerësime të Ramizit, nuk janë të Komisionit.

KRYESUESI: Faleminderit!

Atëherë, deputetët le të hyjnë në sallë për të votuar raportin. Në sall janë 62 deputetë.

Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim, votojmë tani!

Konstatoj se me 64 vota “për”, 3 abstenime dhe asnjë “kundër”, Kuvendi miratoi Raportin vjetor të auditimit nga Zyra e Auditorit të Përgjithshëm për vitin 2010.

Pika e fundit është:

12. Shqyrtimi i propozimit të Trustit të Kursimeve Pensionale të Kosovës për uljen e taksave

Ju kisha lutur që të mos dilni derisa ta shqyrtojmë dhe ta miratojmë edhe këtë, me qëllim që ta kryejmë para dreke dhe pastaj të vazhdojnë komisionet dhe Kryesia me punën e vet.

Komisioni për Buxhet dhe Financa e ka shqyrtuar propozimin e Bordit udhëheqës të Trustit të Kursimeve Pensionale të Kosovës për uljen e taksës menaxhuese nga 0,65% në 0,60% dhe Kuvendit i ka rekomanduar për miratim.

Ftoj kryetaren e Komisionit për Buxhet dhe Financa, deputeten Safete Hadergjonaj, për arsyetimin e raportit me rekomandime.

SAFETE HADERGJONAJ: Faleminderit, zoti nënkryetar!

Komisioni për Buxhet dhe Financa e ka shqyrtuar kërkesën të cilën e ka prur Trusti i Kursimeve Pensionale. Në bazë të nenit 19 të Ligjit numër 03/L-084 për ndryshimin e Rregullores së UNMIK-ut numër 2005/20 për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores së UNMIK-ut 2001/35 për Fondin Pensional të Kosovës, si dhe neni 6.2, pika (k) të Rregullores së UNMIK-ut të lartpërmendur për Fondin Pensional të Kosovës, caktimi i tarifave të arsyeshme të bazuara në shpenzimet operationale të çdo pjesëmarrësi për administrimin e llogarive individuale, në këtë rast shpenzimet operationale dhe menaxhuese të Trustit Pensional, si dhe administruesi i llogarive individuale dhe ndalimi i shumave të tyre nga kontributet e marra bëhet para derdhjes së tyre në llogaritë individuale, në pajtim me orarin të cilin e përcakton Kuvendi.

Bordi Udhëheqës i Trustit të Kursimeve Pensionale të Kosovës, në pajtim me dispozitat e lartpërmendura në nenin 18 dhe 19, i ka propozuar Kuvendit miratimin e uljes së taksës menaxhuese vjetore nga 0,65% në 0,60% mbi Fondin Pensional.

Sipas uljes së kësaj takse, është paraparë që gjatë vitit 2012 Trusti i Kursimeve Pensionale të Kosovës të ketë nën administrim apo nën menaxhim 621 milion euro, duke ngarkuar taksën menaxhuese vjetore prej 0.60% mbi Fondin Pensional, siç është propozuar. Trusti i Kursimeve Pensionale të Kosovës në vitin 2012 parasheh të sigurojë të hyra prej 3.735.000 euro. Buxheti i aprovuar për këtë vit është 3.890.000 euro dhe në tërësi buxheti për vitin 2012 është ngritur në krahasim me buxhetin e vitit 2011 për 12.000 euro.

Komisioni për Buxhet dhe Financa, në mbledhjen e mbajtur më 18 tetor 2011, e ka shqyrtuar këtë propozim të Trustit të Kursimeve Pensionale dhe njëzëri ka përkrahur propozimin e tillë.

Me qenë se aktivitetet operationale dhe menaxhuese të Trustit mbulohen nga mjetet që inkasohen si rezultat i caktimit të taksës në llogaritë individuale të kontribuuesve, komisioni i sugjeroi Bordit udhëheqës të Trustit që me qëllim të menaxhimit më të mirë të mjeteve pensionale, investimi i këtyre mjeteve pensionale në kompanitë investive të bëhet në bazë të performancës së tyre.

Prandaj, si përfundim, komisioni i rekomandon deputetët që të bëjnë miratimin e uljes së kësaj takse menaxhuese sipas kërkesës së Trustit Pensional. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit!

Në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së është paraqitur deputetja, Krasniqi.

HASIME KRASNIQI: Faleminderit, zoti nënkryetar!

Të nderuar ministra,

Të nderuar kolegë deputetë dhe deputete,

Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës e ka shqyrtuar propozimin e Bordit udhëheqës të Trustit të Kursimeve Pensionale të Kosovës për uljen e taksës menaxhuese prej 0.65% në 0.60%, e cila do të hyjë në fuqi nga 1 janari i vitit 2012. Ky propozim është arsyetuar nga ana e Bordit udhëheqës me rritjen e kontribuuesve për kursime pensionale.

Andaj, Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës do ta votojë këtë propozim. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit!

Të paraqitur janë ata që janë paraqitë, ata që nuk janë paraqitur, s'kanë obligim.

Në emër të Grupit Parlamentar të Koalicionit Kosova e Re, deputetja Selmani.

MYZEJENE SELMANI: Faleminderit, nënkryetar!

Përshëndetje për dy ministrat dhe gjithë deputetë që janë në seancë!

Duke marrë parasysh rekomandimet që kanë ardhur nga Komisioni për Buxhet, shihet mjaftë qartë se arsyetimin e dha edhe kryetarja e Komisionit, në bazë të ligjeve të cilat janë në funksion. Atëherë, edhe Koalicioni për Kosovë të Re përkrah uljen e taksës menaxhuese nga 0.65% në 0.60% që kjo të zbatohet nga janari i vitit 2012. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Në emër të Grupit Parlamentar “Vetëvendosje”, deputeti Aliu.

ALIBURN ALIU: Faleminderit!

Grupi parlamentar i Lëvizjes “Vetëvendosje” e ka shqyrtuar dhe e miraton kërkesën e Trustit të Kursimeve Pensionale të Kosovës për reduktimin e taksës menaxhuese për kursime pensionale.

Konsiderojmë që ulja e kësaj takse ia lehtëson sado pak qytetarit barrën financiare të menaxhimit të tyre të kursimeve të obligueshme. Madje, në bazë të tabelave të dorëzuara nga Trusi dhe shpjegimet përcjellëse, shohim qartë që kjo taksë ndoshta do të mund të reduktohej edhe më tutje, me qenë se Trusti vazhdon të bartë nga viti në vit shumën e donacionit qeveritar të paguar me fillimin e punës së këtij institucioni, pa pasur nevojë asnjëherë për ta shpenzuar këtë.

Pra, ne e miratojmë këtë kërkesë të Trustit.

KRYESUESI: Faleminderit, zoti Aliu!

Fjalën e ka deputeti Milosavljeviq, në emër të Grupit Parlamentar SLS.

SAŠA MILOSAVLJEVIĆ: Hvala, gospodine predsedavajući!

I Samostalna liberalna stranka je razmotrila predlog Trusta penzionih štednji Kosova o smanjenju administrativnih taksi i mi ćemo da podržimo ovaj predlog.

KRYESUESI: Faleminderit!

Deputeti, Osmani e ka fjalën.

NASER OSMANI: Faleminderit, kryesues!

Mendoj që nuk ishte e nevojshme fjala e askujt më mbas fjalës së kryetares së Komisionit për Buxhet dhe Financa, pasi që ligji e parasheh që propozimin e Komisionit Kuvendi e aprovon vjet për vjet dhe është një vendim i cili është marrë me konsensus në komision, andaj konsideroj që kjo vetëm duhet të qitet në votim edhe të aprovohet. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit!

Atëherë, vazhdojmë me votimin e propozimit të Bordit udhëheqës të Trustit të Kursimeve Pensionale për uljen e takës menaxhuese nga 0.65% në 0.60%.

Konstatohet që në sallë janë prezentë 68 deputetë.

Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim, votojmë tani!

Konstatohet se me 65 vota “për”, 2 “kundër” dhe 1 abstenim, Kuvendi miratoi propozimin e Bordit udhëheqës të Trustit të Kursimeve Pensionale të Kosovës për uljen e taksës menaxhuese nga 0.65% në 0.60%.

Ftoj kryetarët e grupeve parlamentare dhe anëtarët e Kryesisë që në ora 12:15 të jenë në mbledhjen e Kryesisë. Faleminderit!

Përgatiti:

Njësia e Transkripteve e Kuvendit të Kosovës